



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

**RREGULLORE**

**PËR**

**FORMULARIN E KËRKESËS, PËRMBAJTJEN E DOKUMENTACIONIT PËR  
MIRATIM PROSPEKTI PËR EMETIMIN E OBLIGACIONEVE**

*Miraturar me Vendimin e Bordit nr. 16, datë 31.01.2018*

**Neni 1**

**Objekti i rregullores**

Kjo rregullore përcakton mënyrën e aplikimit për marrjen e miratimit të prospektit për emetimin e obligacioneve me ofertë private dhe publike, si dhe dokumentacionin përkatës.

**Neni 2**

**Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të nenit 30 të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”.

**Neni 3**

**Fusha e veprimit**

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha subjektet e lejuara nga Ligji “Për titujt” dhe Ligji “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”, të quajtura në vijim “emetues”, që kërkojnë të emetojnë obligacione me ofertë private dhe publike.

## Neni 4

### Formulari i kërkesës

Emetuesi, përpara publikimit ose dorëzimit të prospektit tek investitorët e mundshëm, paraqet për miratim në Autoritet prospektin sipas formularit të kërkesës të paraqitur në aneksin 1 të kësaj rregulloreje.

## Neni 5

### Dokumentat që shoqërojnë formularin e kërkesës

Formulari i kërkesës për miratim të prospektit shoqërohet me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Ekstrakti më i fundit i regjistrimit të shoqërisë tregtare, i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në bazë të nenit 22 e në vijim të Ligjit nr. 9723 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- b. Dokumenti që vërteton gjendjen penale të administratorit, dhe/ose të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës/administrimit (formular vetëdeklarimi ose dëshmi e gjendjes gjyqësore). Në rastin e një oferte publike, administratori dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës/administrimit duhet të plotësojnë deklaratën sipas aneksit 2 të kësaj rregulloreje;
- c. Vendimi i organit kompetent për emetimin e obligacionit;
- d. Vendimi i asamblesë së përgjithshme për emetimin e obligacionit të konvertueshëm **[në rastin e obligacioneve të tilla];**
- e. Letër miratimi nga një autoritet tjetër **[nëse e kërkon legjislacioni në fuqi];**
- f. Kopje e formës së garancisë/dorëzimit dhe opinionit ligjor për ekzekutimin e saj **[nëse ka, në rastin e ofertës publike];**
- g. Marrëveshja me shoqërinë audituese/auditues ligjor;
- h. Marrëveshja me kujdestarin/regjistrarin;
- i. Marrëveshja me profesionistë të tjerë **[sipas rastit]**
  - Këshilltari i emetuesit;
  - Këshilltari juridik;
  - Agjenti i zotëruesve të obligacioneve.
- j. Deklaratë – tip e investitorit për marrjen përsipër të rreziqeve nga investimi në obligacione **[në rastin kur oferta private i shitet investitorëve individualë]**, sipas tekstit të paraqitur në aneksin 7 të kësaj rregulloreje;
- k. Prospekti;
- l. Dokumenti “Ç” duhet të dimë në lidhje me investimin në obligacione”, sipas tekstit të paraqitur në aneksin 6 të kësaj rregulloreje;
- ll. Formulari i kërkesës për investim në një emetim të ri obligacionesh sipas aneksit 5 të kësaj rregulloreje;
- m. Dokument që vërteton kryerjen e pagesës ndaj AMF-së për trajtimin e kërkesës.

## **Neni 6**

### **Prospekti tip për emetimin e obligacioneve**

Në rastin e emetimit të obligacioneve me ofertë private, prospekti duhet të hartohet sipas përmbajtjes të paraqitur në aneksin 3 të kësaj rregulloreje. Prospekti është privat dhe u shpërndahet një numri të kufizuar investitorësh dhe nuk mund t'i jepet askujt tjetër përveç investitorit të synuar që në fillim dhe nuk mund të riprodhohet apo përdoret për qëllime të tjera.

Në rastin e emetimit të obligacioneve me ofertë publike, prospekti duhet të hartohet sipas përmbajtjes të paraqitur në aneksin 4 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 7**

### **Dispozitë kalimtare**

Të gjitha subjektet që kanë aplikuar, për marrjen e miratimit nga Autoriteti për prospekten për emetimin e obligacioneve, para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të vijojnë procedurat sipas kërkesave të Ligjit nr. 9879 “Për Titujt” dhe Ligjit nr.10158 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore” dhe praktikave më të mira.

## **Neni 8**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në datë 1 mars të vitit 2018.

## ANEKSI 1

### KËRKESË PËR MIRATIM PROSPEKTI

#### DREJTUAR: AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

(Kjo kërkesë nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i autorizuar i emetuesit/ose kryetari i këshillit mbikëqyrës/administrimit)

Në cilësinë e përfaqësuesit/ kryetarit të këshillit mbikëqyrës/administrimit të shoqërisë (emri i shoqërisë) paraqes kërkesën për miratim prospekti.

Për aq sa kam dijeni dhe besim, emetuesi:

1. I ka përmbushur të gjitha kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore për bërjen e ofertës **[private/publike - zgjidhet fjala e duhur sipas rastit]** të obligacioneve **[përcaktohet lloji i obligacionit]**
2. I ka përfshirë të gjitha informacionet që kërkon Ligji nr. 9879 “Për titujt” dhe Ligji nr.10158 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore", dhe
3. I ka vënë ose do t'i vërë në dispozicion të gjitha dokumentet dhe materialet sipas kërkesës nga AMF.

Konfirmoj se nuk ka fakte të tjera të lidhura me kërkesën për miratimin e ofertës [private/publike, sipas rastit] të cilat, sipas mendimit tim, do të duhej t'i bëheshin të ditura AMF-së.

Gjithashtu konfirmoj se jam në dijeni:

1. Se emetuesi është në përputhje me kërkesat rregullative për realizimin e ofertës **[private/publike, sipas rastit]** duke përfshirë edhe vënien në dispozicion të çdo personi të interesuar për prospektin e obligacioneve, të dokumentit “Ç’ duhet të dimë në lidhje me investimin në obligacione”;
2. të përgjegjësive dhe detyrimeve si përfaqësues ligjor i autorizuar i emetuesit/ose kryetari i këshillit mbikëqyrës/administrimit të shoqërisë, obligacionet e së cilës po emetohen;
3. se çfarë informacioni duhet të behet transparent kundrejt investitorëve të mundshëm, sipas bazës rregullative në fuqi, për t’u dhënë mundësi atyre të ndërmarrin një vendim të bazuar në informim.

Jam në dijeni se AMF, në funksion të përmbushjes së përgjegjësive të veta, mund të shkëmbejë çdo informacion përkatës me organe të tjera përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut financiar apo autoritete të tjera kompetente.

Nënshkruar në emër të emetuesit nga përfaqësuesi ligjor i autorizuar i emetuesit/ose kryetari i këshillit mbikëqyrës/administrimit.

Emri:

Nënshkrimi:

Data:

## ANEKSI 2

### DEKLARATË MBI PËRSHTATSHMËRINË E ADMINISTRATORIT DHE ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRES/ADMINISTRIMIT

Unë, i nënshkruari, [*emri dhe mbiemri*], me adresë: [*adresa e banimit*], deklaroj me përgjegjësi të plotë dhe me vërtetësi se:

Jam administrator/anëtar i këshilli mbikëqyrës te shoqërisë [*emri i shoqërisë*] dhe konfirmoj se:

(a) Nuk kam qenë objekt procesi penal apo civil apo veprimi tjetër të zbatimit me forcë të ligjit nga asnjë institucion shtetëror ku të jem shpallur fajtor për sjellje që përfshin mashtrim, pandershmëri, gënjeshtër, fshehje të fakteve me rëndësi materiale apo shkelje të detyrës;

(b) Nuk më është refuzuar, pezulluar apo anuluar anëtarësimi në asnjë organ profesional për shkak sjelljeje nga ana ime që përfshin mashtrim, pandershmëri, gënjeshtër, fshehje të fakteve me rëndësi materiale apo shkelje të detyrës;

(c) Nuk kam qenë objekt mase disiplinore (përfshirë vërejtje të rëndë, sanksion monetar ose urdhër ndalimi) nga autoriteti përgjegjës për rregullimin e tregjeve të titujve për shkak mospërputhshmërie me detyrimet e mia si administrator/anëtar këshilli i një shoqërie tregtare që emeton tituj;

(d) Asnjë shoqëri tregtare administrator/anëtar i këshillit të së cilës kam qenë në momentin e sjelljes në fjalë nuk ka qenë objekt mase disiplinore (përfshirë vërejtje të rëndë, sanksion monetar, pezullim tregtimit ose heqje të regjistrimit në bursë) nga autoriteti përgjegjës për rregullimin e tregjeve të letrave me vlerë për shkak mospërputhshmërie me aktet nënligjore; dhe

(e) Nuk kam dijeni për asnjë hetim, të thelluar ose paraprak, të papërfunduar apo që pritet të fillojë nga një institucion shtetëror, organ profesional, bursë titujsh apo autoritet tjetër përgjegjës për rregullimin e tregjeve të titujve që mund të çojë në procedim ose masë të llojeve të përshkruara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d” më lart.

Aktualisht, jam banor i [*emri i shtetit*] prej [*vjetësh*]. [Në [ ] vitet e fundit, kam banuar në [*emrat e shteteve*].

Nuk mund të marr vërtetim të gjendjes penale për [*këtu futet emri ose emrat e shteteve për të cilat nuk mund të merret vërtetim i të shkuarës penale*] sepse [*një përshkrim i arsyes ose arsyeve përse nuk mund të merret vërtetim i të shkuarës penale*].

Konfirmoj se nuk jam shpallur fajtor në [*emri ose emrat e shteteve përkatëse për të cilat nuk mund të merret vërtetim i të shkuarës penale*] ose gjatë për asnjë vepër penale që ka të bëjë me mashtrim, pandershmëri, gënjeshtër, fshehje të fakteve me rëndësi materiale ose shkelje të detyrave të anëtarit të këshillit për të cilat dënimi minimal është 1 vit burgim (pavarësisht

periudhës për të cilën jam dënuar, nëse ka) [me përjashtim [këtu futet një përshkrim i çdo përjashtimi nga kjo pikë dhe një shpjegim i hollësishëm i rrethanave në fjalë]

Nuk mund të marr vërtetim të gjendjes së falimentimit [këtu futet emri ose emrat e shteteve për të cilat nuk mund të merret vërtetim i gjendjes së falimentimit] sepse [një përshkrim i arsyes ose arsyeve përse nuk mund të merret vërtetim i gjendjes së falimentimit].

Konfirmoj se nuk jam shpallur i falimentuar apo objekt procedure falimentimi nën administrim në [emri ose emrat e vendit përkatës për të cilin nuk mund të merret vërtetim i gjendjes së falimentimit] ose gjetkë [me përjashtim [këtu futet një përshkrim i çdo përjashtimi nga kjo pikë dhe një shpjegim i hollësishëm i rrethanave në fjalë]

E lëshoj këtë deklaratë me vullnetin tim të plotë.

[Data dhe vendi]

*Nënshkrimi i deklaruesit*

Në prani të një noteri

*[emri mbiemri i noterit]*

*[nënshkrimi] [data]*

## ANEKSI 3

### PROSPEKTI TIP PËR OBLIGACIONE ME OFERTË PRIVATE TË EMETUESIT

#### **[Faqja e parë jep informacionin si më poshtë]**

**Emri i emetuesit [shoqëria tregtare]**

**Shuma e emetimit**

Shembull: 200.000.000 lekë

**Lloji i obligacionit: [i garantuar, i pa garantuar, i konvertueshëm, etj.]**

Shembull: Obligacion i pagarrantuar

Shembull: Norma e interesit: 7%

Shembull: Afati i shlyerjes 5 vjet

**KËSHILLTARËT E EMETIMIT [bankë investimesh, këshilltar investimesh apo broker]**  
**APO KËSHILLTARI JURIDIK, nëse emetuesi vendos të emërojë një të tillë.**

[Emri dhe adresa]

**EKSPERTI KONTABËL**

[Emri dhe adresa]

**INVESTIMI NË KËTË OBLIGACION SHOQËROHET ME DISA RISQE. JU REKOMANDOHET TË MBANI PARASYSH FAKTORËT E PËRSHKRUAR NË RUBRIKËN 2 “FAKTORËT E RISKUT” TË KËTIJ PROSPEKTI.**

**PROSPEKT, DATË [data]**

"Me besimin tonë maksimal dhe në bazë të gjithë informacioneve dhe të dhënave për të cilat jemi në dijeni, deklarojmë se të gjitha të dhënat që përmbahen në këtë prospekt përbëjnë paraqitje të plotë dhe të vërtetë të aktiveve dhe pasiveve, fitimeve dhe humbjeve, gjendjes financiare dhe operacioneve të emetuesit, të të drejtave të lidhura me titujt për të cilët është përgatitur ky prospekt dhe se nga ai nuk janë hequr fakte dhe të dhëna të cilat mund të influencojnë në plotësinë dhe vërtetësinë e këtij prospekti."

**Nënshkruar nga [përfaqësuesi i autorizuar i emetuesit]**

**Ky prospekt është rreptësisht privat dhe i rezervuar dhe u shpërndahe një numri të kufizuar investitorësh e nuk mund t'i jepet askujt tjetër përveç se marrësit të synuar fillimisht, dhe nuk mund të riprodhohet apo përdoret për qëllime të tjera.**



## **[Faqja e dytë ka përmbajtjen si më poshtë]**

### **NJOFTIME TË RËNDËSISHME PËR INVESTITORIN**

Ky dokument (“**Prospekti**”) është hartuar në përputhje me rregullat në lidhje me përgatitjen e prospektit dhe lidhet me ofertën private nga [emri i shoqërisë] (“**Emetuesi**”) të obligacionit të saj [specifikoni obligacionin, si për shembull obligacioni i paguarantuar, i emetuar në lekë, me normë interesi 7%, me afat 5 vjet] me çmim [...për qind] e vlerës nominale.

Obligacionet janë instrumente borxhi lirisht të transferueshme dhe pritet të emetohen nga emetuesi më [data]. Vlera nominale e çdo obligacioni është [10,000 lekë]; shuma minimale e nënshkrimit për çdo investitor është [shuma e nënshkrimit minimal në lekë]; shuma nominale maksimale e obligacioneve që pritet të emetohen është [200,000,000 lekë] ne nr. Copë [20.000 obligacione].

Obligacionet janë objekt i kërkesave të legjislacionit tatimor shqiptar.

Ky prospekt përmban informacione të rëndësishme për emetuesin dhe qëllimin për të cilin emetohen obligacionet. Ky prospekt përshkruan edhe risqet që lidhen me emetuesin dhe risqet që lidhen me investimin në obligacionet.

Ju rekomandohet ta lexoni dhe kuptoni plotësisht përmbajtjen e këtij prospekti përpara se të merrni ndonjë vendim për të investuar në obligacione.

#### ***Përgjegjësia për informacionet që përmban ky prospekt***

Emetuesi pranon përgjegjësinë për informacionet që përmban ky prospekt. Informacioni që përmban ky prospekt përputhet me faktet dhe nuk lë pa përfshirë asnjë informacion që do të cenonte rëndësinë e këtij prospekti.

Kur informacionet kanë burim të tretë, këto informacione janë riprodhuar me saktësi dhe emetuesi është në gjendje të qartësojë informacionet e botuara nga ky i tretë, si dhe asnjë fakt nuk është lënë jashtë që do ta bënte të pasaktë apo keqorientues informacionin e riprodhuar. Burimi i informacioneve nga të tretë identifikohet.

**AMF ka konfirmuar vetëm që ky prospekt është në përputhje me kërkesat mbi emetimin e titujve sipas Ligjit nr.9879 “Për titujt” dhe Ligji nr.10158 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore”. AMF nuk verifikon informacionet që përmban ky prospekt dhe nuk bën asnjë rekomandim për përshtatshmërinë e investimit në obligacione për asnjë person. Çdo investitor mban përgjegjësi vetë për vendimin e tij mbështetur në informacionet që përmban ky prospekt dhe, nëse ka dyshime, është mirë të konsultohet me një këshilltar profesional.**

Prospekti duhet të përmbajë rubrikat si më poshtë:

## RUBRIKA 1 – PËRMBLEDHJE

Kjo është një përmbledhje e të gjitha të dhënave që jepen më pas në këtë prospekt.

<b>Rubrika A – Hyrje</b>	
<b>A.1</b>	Kjo përmbledhje duhet konsideruar si hyrje e këtij prospekti. Çdo vendim për të investuar në <b>[këtu futet lloji i obligacionit të [emri i shoqërisë tregtare] (“emetuesi”)]</b> duhet mbështetur në marrjen në konsideratë të këtij prospekti si një dokument i tërë nga ana e investitorit.
<b>A.2</b>	<p>(i) Emetuesi <b>[emri i shoqërisë tregtare]</b>, këshilltari i tij <b>[emri i këshilltarit nëse përdoret një këshilltar]</b> dhe çdo ndërmjetës financiar i emëruar për shitjen e obligacioneve <b>[emetuesi do të caktojë një ose më shumë agjentë të shitjes të përshkruar si shpërndarës të autorizuar]</b> jep pëlqimin për përdorimin e këtij prospekti në lidhje me ofertën private të obligacioneve, përfshirë çdo rishitje të mëpasshme ose ofertë përfundimtare të obligacioneve nga ana e ndërmjetësve financiarë në Shqipëri gjatë periudhës që fillon nga data e këtij prospekti deri në <b>[këtu futet ora dhe data]</b> (“periudha e ofertës”).</p> <p>(ii) Këshilltari; <b>[emri, nëse përdoret]</b>.</p> <p>(iii) Çdo ndërmjetës financiar i emëruar dhe emri i të cilit publikohet më poshtë dhe identifikohet si shpërndarës i autorizuar (sipas përkufizimit të mëposhtëm) në lidhje me ofertën private.</p> <p><b>[Vini re: Sa më poshtë i jep garanci investitorit se personi që bën ofertën është i licencuar nga AMF dhe i autorizuar nga emetuesi].</b></p> <p><i>Ne, [emri/emrat e ndërmjetësve financiarë], i referohemi ofertës së [lloji i obligacioneve] të përshkruar në prospektin e datës [data] (“prospekti”) shpërndarë nga [emri i shoqërisë tregtare]. Duke marrë parasysh se emetuesi ofron të na japë pëlqimin për ta përdorur prospektin në lidhje me ofertën e obligacioneve në Shqipëri gjatë periudhës së ofertës në përputhje me kushtet (e vendosura në prospekt), përmes kësaj deklarate e pranojmë këtë ofertë të emetuesit. Konfirmojmë se jemi të licencuar nga AMF për të bërë një ofertë private dhe se e përdorim prospektin në lidhje me bërjen e një oferte private.</i></p> <p><i>Ndërmjetësit financiarë të përmendur më lart, së bashku do të quhen këtu si “shpërndarës të autorizuar”.</i></p> <p><i>Përveçse sa thuhet më lart, emetuesi nuk ka autorizuar bërjen e një oferte private nga asnjë person në asnjë rrethanë dhe personave të tillë nuk u lejohet ta përdorin këtë prospekt lidhur me ndonjë ofertë obligacionesh. Oferta të tilla nuk bëhen në emër të emetuesit dhe emetuesi nuk mban asnjë përgjegjësi për veprime të personave të tillë që bëjnë oferta të tilla.</i></p>

<b>Rubrika B – Të dhëna për emetuesin</b>		
<b>B.1</b>	<b>Emri juridik dhe tregtar</b>	Emri juridik dhe tregtar i emetuesit është <b><u>[emri i shoqërisë]</u></b>
<b>B.2</b>	<b>Selia e regjistruar dhe forma juridike</b>	Emetuesi është shoqëri tregtare e themeluar dhe regjistruar në Shqipëri <b><u>[jepen të dhënat e autoritetit themelues dhe miratues]</u></b>
<b>B.3</b>	<b>Emrat e anëtarëve të këshillit dhe/ose administratorit</b>	<b>[Emrat dhe titujt e plotë të anëtarëve të këshillit dhe/ose administratorit]</b>
<b>B.4</b>	<b>Përshkrim i çdo trendi të njohur që prek emetuesin dhe dorëzanësin <u>[nëse ka]</u></b>	
<b>B.5</b>	<b>Konstatime nga raporti i ekspertit kontabël</b>	<b><u>[Thuhet nëse llogaritë ose pasqyrat financiare kanë qenë objekt i raportit me rezerva ose i vërejtjeve nga eksperti kontabël apo nga ndonjë autoritet tjetër]</u></b>
<b>B.6</b>	<b>Të dhëna financiare historike të për zgjedhura</b>	<p>Të dhënat e mëposhtme financiare të përmbledhura më datën e pasqyrave financiare dhe për secilin vit financiar të mbyllur, <b><u>[bëhen të ditura vitet]</u></b>.</p> <p>Nuk ka pasur asnjë ndryshim të konsiderueshëm në pozicionin financiar ose tregtues të emetuesit dhe nuk ka pasur ndryshime të padëshirueshme me rëndësi materiale të perspektivave të emetuesit, pas datës së pasqyrave financiare.</p> <p><b>Të dhënat financiare kryesore të konsoliduara të emetuesit.</b></p> <p><b><u>[Këtu jepet një përmbledhje e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, bilancit dhe pasqyrës së flukseve monetare për vitin e mbyllur dhe për vitin në vazhdim. Nëse është e nevojshme, mund të jepet si lidhje pasqyrat financiare të plota.]</u></b></p>
<b>B.7</b>	<b>Ngjarje të fundit të lidhura me vlerësimin e aftësisë pagueuse të emetuesit</b>	<b><u>[Identifikohen, nëse ka]</u></b>

B.8	Përshkrim i shoqërisë tregtare	<u>[Përshkrim i plotë i veprimtarisë tregtare të emetuesit]</u>
B.9	Vlerësimi i aftësisë kredimarrëse (nëse ka)	<u>[Nëse emetuesi ka një vlerësim kreditor, jepet këtu]</u>

<b>Rubrika C – Të dhëna për obligacionet</b>		
C.1	Lloji dhe klasa e obligacioneve	<u>[Obligacione pa garanci në lekë me normë interesi 7 për qind me afat 5 vjet]</u> do të emetohen më <u>[data]</u> (“data e emetimit”) në formë të dematerializuar. Vlera nominale e çdo obligacioni (që është shuma e përdorur në llogaritjen e pagesave të bëra për çdo obligacion) është 10.000 lekë. <u>[Nëse obligacionet janë të mbuluara me garanci ose dorëzani ose janë të konvertueshme, kjo duhet thënë këtu dhe të jepen disa të dhëna për këtë]</u> Numri Ndërkombëtar i Identifikimit të Letrave me Vlerë ose Numri Shqiptar i Identifikimit të Letrave me Vlerë për obligacionet është <u>[këtu futet numri, nëse ka]</u>
C.2	Monedha e obligacionit	Lekë (ALL) <u>[ose shprehet monedha përkatëse]</u>
C.3	Kufizimet mbi kalimin e pronësisë mbi obligacionin	<u>[Nëse ka kufizime të tilla; ose thuhet se nuk ka kufizime mbi kalimin lirisht të pronësisë së obligacioneve]</u>
C.4	Të drejtat e lidhura me obligacionin	<i>Statusi i obligacionit</i> Obligacionet përbëjnë detyrime <u>[futet statusi, si për shembull pa garanci]</u> të emetuesit. Për rrjedhojë ato renditen pas obligacioneve <u>[futet fjala e duhur, si me garanci]</u> . Obligacionet renditen <i>pari passu</i> (pra, në mënyrë të barabartë) dhe pa përparësi mes tyre.  <u>[Nëse obligacionet janë të mbuluara me garanci ose dorëzani jepen të dhëna të garancisë ose dorëzanisë. Nëse ka një dorëzanës të jashtëm, jepen të dhëna përfshirë pasqyrat financiare si në pikën B6 më lart]</u>
C.5		<u>Shlyerje fakultative përpara afatit nga emetuesi [nëse kjo është e mundshme, atëherë jepen kushtet përkatëse]</u>
C.6	Komponenti derivativ i obligacionit	<u>[Shënoni nëse ka një të drejtë për shlyerje përpara afatit dhe në çfarë rrethanash]</u>

C.7	<b>Regjistrimi në bursë dhe pranimi për tregtim</b>	Kjo është ofertë private. Obligacionet nuk regjistrohen apo tregtohen në tregun zyrtar të Bursës.
-----	---	---

<b>Rubrika D Risqet kryesore</b>		
D.1	<b>Risqet kryesore që janë specifike për emetuesin</b>	<b><u>[Këtu futen risqet kryesore ndaj biznesit të emetuesit – duhet të jetë një seri e plotë e risqeve të biznesit]</u></b>
D.2	<b>Risqet kryesore që janë specifike për obligacionet</b>	Investimi në obligacione, së pari përfshin riskun e ndryshimit të normave të interesit në treg, që mund të prekin negativisht vlerën e obligacioneve. Nëse rriten normat e interesit, atëherë norma e të ardhurës e pagueshme për obligacionet mund të bëhet më pak tërheqëse për investitorët. Risqet e tjera.
D.3	<b>Risqet kryesore lidhur me shitjen e obligacioneve përpara maturimit</b>	Nëse do të keni nevojë apo dëshirë t'i shisni obligacionet përpara maturimit, çmimi që do të merrni mund të jetë më i ulët se shuma që keni paguar për blerjen e obligacioneve në emetim.

<b>Rubrika E – Të dhëna për ofertën</b>		
E.1	<b>Arsyet e ofertës dhe përdorimi i fondeve</b>	Oferta e obligacioneve bëhet <b><u>[arsyeja – në arsyet e zakonshme përfshihen: për të rritur numrin e burimeve të financimit të shoqërisë; për të shlyer borxhet ekzistuese të shoqërisë; në funksion të kapitalit qarkullues të shoqërisë]</u></b> .

E.2	<b>Kushtet e ofertës</b>	<p>Oferta pritet të hapet më datën e këtij prospekti dhe të mbyllet në <b>[ora]</b> më <b>[data]</b>, ose në një orë dhe datë të mëparshme që do të shpallet nga emetuesi.</p> <p>Obligacionet do të emetohen me çmimin e emetimit (jepet përqindja e vlerës nominale) dhe shuma nominale agregate e obligacioneve që do të emetohen.</p> <p>Shpërndarësit e autorizuar mund t'i ofrojnë obligacionet me çmimin e emetimit (jepet përqindja e vlerës nominale të obligacioneve) ose, nëse shpërndarësi i autorizuar ju faturon shpenzimet e veta, mund t'ju ofrojnë obligacionet për një shumë përkatëse që është më e lartë se çmimi i emetimit. Për shembull, nëse banka, brokeri ose këshilltari juaj financiar ju kërkon të paguani shpenzimet e tregtimit, për shembull prej 1 për qind, dhe çmimi i emetimit është 100, atëherë obligacionin do t'ju ofrojnë kundrejt 101. Duhet të pyesni bankën, brokerin ose këshilltarin tuaj financiar se çfarë shpenzimesh do t'ju kërkojnë të mbuloni dhe, për rrjedhojë, çfarë çmimi ju ofrojnë dhe cilat do të jenë tarifatat përkatëse nëse kërkesa juaj nuk del me sukses. Çdo shpenzim i tillë, nuk është përgjegjësi e emetuesit. Kjo duhet t'i bëhet e ditur çdo investitori të mundshëm nga ana e shpërndarësit të autorizuar në momentin përkatës.</p> <p><b><u>[Vini re: kjo i jep mundësi shpërndarësit të autorizuar, bankës ose brokerit të shtojë një komision ose tarifë]</u></b></p>
E.3	<b>Nënshkrimi minimal</b>	<p>Shuma minimale e nënshkrimit për investitor është për vlerën nominale prej <b>[për shembull, 200.000 lekë]</b> të obligacioneve në shpërndarje fillestare. Shuma minimale e obligacioneve që është e nevojshme për përfundimin e emetimit është <b>[për shembull 150.000.000 lekë]</b> shuma maksimale e obligacioneve që do të emetojë emetuesi sipas ofertës është <b>[për shembull 200.000.000 lekë]</b> si vlerë nominale agregate.</p>
E.4	<b>Interesat me rëndësi materiale për ofertën</b>	<p><b><u>[Këtu shprehet nëse ka interesa të veçanta; përndryshe thuhet se për aq sa është në dijeni emetuesi, asnjë person i përfshirë në emetimin/ofertën e obligacioneve nuk ka asnjë interes me rëndësi materiale për ofertën, përfshirë edhe interesa në konflikt.]</u></b></p>
E.5	<b>Shpenzimet e çmuara që i ngarkohen investitorit</b>	<p>Emetuesi nuk do t'ju ngarkojë asnjë shpenzim apo taksë lidhur me kërkesën për obligacione apo blerjen e obligacioneve.</p> <p>Por mund t'ju ngarkojë shpenzime shpërndarësi i autorizuar. Shpenzime të tilla janë jashtë kontrollit të emetuesit, nuk dihen nga emetuesi dhe duhet t'i bëhen të ditura çdo investitori të mundshëm nga ana e shpërndarësit të autorizuar në momentin përkatës. Ju rekomandohet të verifikoni nëse do t'ju ngarkohen pagesa të tilla pavarësisht nga suksesi i kërkesës.</p>

## RUBRIKA 2 FAKTORËT E RISKUT

### Yield

Yield-i (pra, kthimi mbi obligacionet) i shprehur në këtë prospekt (shih Rubrikën 3 (*Informacion për obligacionet – Cili është yield-i i obligacioneve?*)) vlen vetëm për investimet e bëra me çmimin e emetimit (jo më pak ose më shumë, pra 100 për qind i çmimit) të obligacioneve. Nëse investoni në këto obligacione me një çmim që nuk është çmimi emetimit të obligacioneve, kthimi mbi investimin do të jetë i ndryshëm nga yield-i i shprehur në prospekt.

### **Konvertimi në para nga shitja e obligacioneve përpara datës së parashikuar të maturimit**

Nëse vendosni t'i shisni obligacionet në çdo moment përpara datës së maturimit, çmimi i marrë nga një shitje e tillë mund të jetë më i ulët se investimi fillestar që keni bërë. Faktorët që ndikojnë në çmim mund të përfshijnë, ndër të tjera, “oreksin” e tregut, inflacionin, kohën e shlyerjes, normat e interesit dhe pozicionin financiar aktual dhe një analizë të perspektivave të emetuesit në momentin përkatës.

### **Luhatjet e normave të interesit dhe masat kontrolluese të bursës mund të ndikojnë negativisht në kthimin mbi investimet në obligacione dhe/ose vlerën e tregut të obligacioneve.**

Emetuesi do të paguajë principalin dhe interesin e obligacioneve [lekë]. Kjo paraqet disa risqe të caktuara lidhur me konvertimin valutor nëse veprimtaritë financiare i keni të shprehura kryesisht në një monedhë ose njësi monetare (“monedha e investitorit”) që nuk është [leku]. Këtu përfshihet risku se kursi i këmbimi valutor mund të ndryshojë ndjeshëm (përfshirë ndryshimet për shkak të zhvlerësimit të [lekut] apo rivlerësimit të monedhës së investitorit) dhe risku se autoritetet që kanë kompetencë mbi monedhën e investitorit mund të vendosin ose të modifikojnë masa kontrolluese. Fuqizimi i monedhës së investitorit në raport me [lekun] do ta ulte:

- a. Yield-in ekuivalent në monedhën e investitorit mbi obligacionet;
- b. Vlerën ekuivalente në monedhën e investitorit të principalit të pagueshëm mbi obligacionet; dhe
- c. Vlerën e tregut ekuivalente në monedhën e investitorit mbi obligacionet.

### **Ndryshimet e shkallëve të inflacionit mund të prekin negativisht vlerën e obligacioneve**

Obligacionet përfshijnë interes me normë fikse, pra jo duke iu referuar një indeksi bazë. Prandaj, ju rekomandohet të vëreni se me rritjen e normave të interesit, të ardhurat e pagueshme mbi obligacionet bëhen relativisht më pak tërheqëse dhe çmimi që mund të arrini nga shitja e obligacioneve mund të bjerë. Por kjo nuk ka asnjë ndikim mbi të ardhurat gjithsej që merrni më datën e maturimit të obligacioneve nëse do t'i mbani deri më këtë datë obligacionet. Gjithashtu, inflacioni e ul vlerën reale të obligacioneve me kalimin e kohës, çka mund të prekë atë që mund të blini me investimin tuaj në të ardhmen dhe mund ta bëjë normën fikse të pagueshme mbi obligacionet relativisht më pak tërheqëse në të ardhmen, çka cenon çmimin që mund të arrinit nga shitja e obligacioneve.

### RUBRIKA 3 INFORMACION PËR OBLIGACIONET

<p><b>Çfarë janë obligacionet</b></p>	<p><b>[Obligacionet pa garanci në lekë me normë interesi 7 për qind me afat 5 vjet] (“obligacionet”)</b> janë instrumente të borxhit të emetuara nga <b>[emri i shoqërisë]</b> (“emetuesi”). Obligacionet janë objekt i “kushteve të obligacioneve” të cilat bëhen të ditura në Rubrikën 14 të këtij prospekti <b>[nëse zbatohen kushte të hollësishme]</b>. Obligacionet:</p> <p>(a) i japin të drejtë mbajtësit të obligacionit të arkëtojë interes me normë fikse interesi prej <b>[7 për qind në vit (i pagueshëm me dy këste të barabarta më datë dhe të çdo viti)]</b>;</p> <p>(c) pritet të emetohen më <b>[data]</b> (“data e emetimit”) dhe të shlyhen plotësisht nga emetuesi më <b>[data]</b> (“data e maturimit”);</p> <p>(d) por në rrethana të caktuara mund të shlyhen përpara datës së maturimit nëse emetuesi vendos kështu ose në rast mospërmbushjeje të kushteve të obligacioneve.</p>
<p><b>Kush i emeton obligacionet?</b></p>	<p>Obligacionet emetohen nga <b>[emri i shoqërisë]</b></p> <p>Shih Rubrikën 7 (<i>Përshkrim i shoqërisë tregtare</i>) për më shumë informacion.</p>
<p><b>A garantohen obligacionet?</b></p>	<p><b>[Të shkruhet sipas rastit; në rastin e shembullit të përdorur në model]</b> Jo. Obligacionet nuk mbulohen me garanci.</p>
<p><b>Për çfarë do të përdoren fondet e ardhura nga emetimi?</b></p>	<p>Emetuesi do t’i përdorë fondet e emetimit për <b>[këtu shkruhet diçka si shlyerje e huamarrjeve ekzistuese dhe për kapital qarkullues i shoqërisë ose për qëllime të tjera]</b></p>
<p><b>Cila është norma e interesit?</b></p>	<p>Norma e interesit e pagueshme mbi obligacionet do të jetë fikse deri më datën e maturimit prej <b>[7 për qind]</b> në vit. Norma e interesit e pagueshme mbi obligacionet është fikse për të gjithë kohëzgjatjen e obligacioneve.</p> <p>Pagesa e parë e interesit në lidhje me obligacionet do të bëhet më <b>[data]</b>.</p> <p>Pas pagesës së parë, interesi pritet të paguhet më <b>[datat]</b> çdo vit deri më datën e maturimit, përfshirë edhe këtë (nëse obligacionet nuk shlyhen më herët).</p>
<p><b>Si llogaritet interesi i pagueshëm?</b></p>	<p>Emetuesi do të paguajë një normë fikse vjetore interesi prej <b>[7 për qind]</b> në lidhje me obligacionet. Interesi do të jetë i pagueshëm në <b>[dy këste gjashtëmuajore]</b>. Pra, për çdo vlerë nominale obligacioni prej 10.000 lekë që do të blini, do të merrni <b>[shuma]</b> më <b>[data]</b> dhe <b>[shuma]</b> më <b>[data]</b>, pra çdo gjashtë muaj deri më datën e maturimit (nëse nuk do të shisni obligacionet ose nëse obligacionet nuk do të shlyhen përpara datës së maturimit).</p>
<p><b>Sa është yield-i i obligacioneve?</b></p>	<p>Në bazë të çmimit të emetimit të obligacioneve prej 100 për qind të vlerës nominale, yield-i fillestar (që është interesi që merret mbi obligacionet i shprehur si përqindje e vlerës nominale) i obligacioneve më datën e emetimit është <b>[7 për qind]</b> si normë</p>



	vjetore. Ky yield fillestar nuk është tregues i yield-it të ardhshëm.
<b>A do të mund t'i tregtoj obligacionet?</b>	Jo. Obligacionet shiten me ofertë private dhe nuk do të regjistrohen ose tregtohen në një treg publik apo bursë.
<b>A kanë vlerësim kreditor obligacionet?</b>	<b><u>[Këtu shkruhet, për shembull: Jo, obligacionet nuk do të vlerësohen në emetim nga asnjë agjenci e vlerësimit kreditor. Aktualisht, emetuesi nuk ka ndër mend të kërkojë vlerësim kreditor nga asnjë agjenci e vlerësimit kreditor OSE këtu futen të dhënat e vlerësimit kreditor]</u></b>
<b>A kanë të drejta votimi obligacionet?</b>	Mbajtësit e obligacioneve kanë disa të drejta të caktuara për të votuar në mbledhjet e mbajtësve të obligacioneve, por nuk kanë të drejtë vote në asamblenë e aksionarëve të emetuesit, dorëzanesve apo anëtarëve të tjerë të grupit. Kushtet e obligacioneve përmbajnë dispozita për thirrjen e mbledhjeve të mbajtësve të obligacioneve për të shqyrtuar çështje që prekin interesat e tyre në përgjithësi. Këto dispozita u japin mundësi shumicave të madhësive të caktuara t'u imponojnë vullnetin e tyre të gjithë mbajtësve të obligacioneve përfshirë edhe ata mbajtës obligacionesh që nuk kanë marrë pjesë dhe nuk kanë votuar në mbledhjen përkatëse dhe mbajtës obligacionesh që kanë votuar ndryshe nga shumica.
<b>Kush i përfaqëson interesat e mbajtësve të obligacioneve?</b>	Agjenti i mbajtësve të obligacioneve emërohet nga emetuesi për të vepruar në emër të mbajtësve të obligacioneve gjatë të gjithës jetës së obligacioneve. Detyrimet kryesore të emetuesit (siç është detyrimi për të paguar interes dhe për të shlyer obligacionet) shqyrtohen nga agjenti i mbajtësve të obligacioneve, roli i të cilit është të mbrojë interesat e mbajtësve <b><u>[individualë]</u></b> të obligacioneve.
<b>Si të bëj kërkesë për obligacionet ?</b>	Për informacion si të bëni kërkesë për obligacionet, shih Rubrikën 4 ( <i>Kalendari i ofertës dhe datat kryesore</i> ) dhe Rubrikën 5 ( <i>Si të bëjmë kërkesë për obligacionet</i> ).
<b>Po sikur të kem pyetje të tjera?</b>	Nëse nuk jeni të qartë në lidhje me ndonjë çështje apo nëse jeni të sigurt nëse obligacionet janë një investim i përshtatshëm, është mirë të kërkonit këshilla profesionale nga banka, brokeri, avokati, kontabilisti ose këshilltari juaj i pavarur financiar përpara se të merrni vendim nëse duhet ose jo të investoni.

## RUBRIKA 4 KALENDARI I OFERTËS DHE DATAT KRYESORE

### Datat kryesore të ofertës

Fillimi i periudhës së ofertës	<b><u>[Këtu futet data përkatëse]</u></b>
Fundi i periudhës së ofertës	<b><u>[Këtu futet data përkatëse]</u></b>
Shpallja (konfirmimi i shumës nominale gjithsej të obligacioneve që do të emetohen)	<b><u>[Këtu futet data përkatëse]</u></b>
Data e emetimit	<b><u>[Këtu futet data përkatëse]</u></b>
<b>Datat kryesore për obligacionet</b>	
Data e parë e pagimit të interesit	<b><u>[Këtu futet data përkatëse]</u></b>
Data e maturimit	<b><u>[Këtu futet data përkatëse]</u></b>

Interesi planifikohet të paguhet më **[datat gjashtëmuajore të pagimit të interesit – tregoni datat]**, deri më datën e maturimit ose deri më datën e shlyerjes përpara afatit. Pagesa e parë e interesit do të bëhet më **[data]**. Nëse ndonjë prej këtyre datave nuk është ditë pune, atëherë pagesa e interesit do të bëhet ditën e parë të ardhshme të punës pa akumuluar interes shtesë.

Ky prospekt mund të përdoret vetëm nga shpërndarësit e autorizuar të përmendur në këtë prospekt në funksion të ofrimit të obligacioneve gjatë periudhës së ofertës; në asnjë rast pas fundit të periudhës së ofertës. Asnjë person që nuk është shpërndarës i autorizuar nuk lejohet të përpunojë kërkesa në emër të një subjekti kërkues.

## RUBRIKA 5 SI TË BËJMË KËRKESË PËR OBLIGACIONET

<b>Si të bëj kërkesë për obligacionet?</b>	Kërkesat mund të bëhen vetëm përmes formularit të kërkesës që jepet si bashkëlidhje dhe është pjesë e këtij prospekti. Kërkesat e bëra në mënyra të tjera nuk do të pranohen.
<b>Si dhe me çfarë kushtesh do të shpërndahen obligacionet?</b>	Kërkesat për të blerë obligacione mund t'i paraqiten drejtpërdrejt <b><u>[emri i emetuesit]</u></b> , ose mund të shpërndahen nëpërmjet shpërndarësit të autorizuar, nga i cili do të merrni informacionin përkatës.
<b>Sa obligacione do t'u emetohen investitorëve?</b>	Shuma gjithsej e obligacioneve që do të emetohen mund të varet nga shuma e obligacioneve për të cilat merren oferta orientuese për të blerë obligacione gjatë periudhës së ofertës. Kjo shumë gjithsej do të specifikohet në një shpallje që synon të publikojë emetuesi <b><u>[këtu përcaktoni si dhe ku do të bëhet shpallja]</u></b> . Shuma nominale minimale e obligacioneve të pranuarra për plotësimin e ofertës do të jetë <b><u>[këtu futet një shifër, si për shembull 150.000.000 lekë]</u></b> . Shuma nominale maksimale e obligacioneve që do të emetohen do të jetë <b><u>[këtu futet një shifër, si për shembull 200.000.000 lekë]</u></b> .

<p><b>Si dhe kur duhet të bëj pagesën për obligacionet që më janë caktuar dhe kur do të më lëvrohen ato?</b></p>	<p>Do të merrni njoftim nga emetuesi apo shpërndarësi i autorizuar për sa i takon obligacioneve që do t’ju caktohen (nëse ka) dhe se si do t’ju lëvrohen obligacionet përkundrejt pagesës.</p>
<p><b>Kur mund të ofrohen për shitje obligacionet?</b></p>	<p>Oferta e obligacioneve fillon që nga data e këtij prospekti deri në <b>[ora dhe data]</b> (“<b>periudha e ofertës</b>”).</p>
<p><b>A ekziston mundësia që të mos më jepet numri i obligacioneve që kam kërkuar? A do të më kthehet pjesa e mbetur e parave që kam paguar?</b></p>	<p>Mund të mos ju caktohen të gjitha (ose asnjë) prej obligacioneve për të cilat keni bërë kërkesë. Për shembull, kjo mund të ndodhë nëse shuma gjithsej e porosive për obligacione e kalon numrin e obligacioneve për emetim. Nuk do të ketë kthim parash sepse nuk do t’ju kërkohet të paguani për obligacionet deri në momentin kur do të jenë pranuar kërkesat për obligacione dhe kur t’ju jenë caktuar obligacione.</p>
<p><b>A ka një shumë minimale apo maksimale obligacionesh për të cilat mund të bëj kërkesë?</b></p>	<p>Shuma minimale e kërkesës për çdo investitor është <b>[për shembull 200.000 lekë]</b>. Shuma nominale maksimale agregate e obligacioneve që pritet të emetohen është <b>[për shembull 200.000.000 lekë]</b>.</p>
<p><b>Si dhe kur do të konfirmohen rezultatet e ofertës së obligacioneve?</b></p>	<p>Do të merrni njoftim nga shpërndarësi i autorizuar përkatës.</p>
<p><b>Kur dhe si do të informohem se sa obligacione më janë caktuar?</b></p>	<p>Do të merrni njoftim nga shpërndarësi i autorizuar përkatës për sa i takon obligacioneve që do t’ju caktohen (nëse ka) në përputhje me rregullimet që keni me shpërndarësin e autorizuar.</p>
<p><b>Kur do të regjistrohen obligacionet pranë kujdestarit/ regjistrarit?</b></p>	<p>Obligacionet nuk kanë formë materiale dhe nuk do të merrni një certifikatë. Do të merrni informacion nga kujdestari/regjistrari pasi të jenë regjistruar obligacionet.</p>
<p><b>Cila është vlera e shpenzimeve dhe tatimeve që do të më ngarkohen në mënyrë specifike?</b></p>	<p>Emetuesi nuk do t’ju ngarkojë asnjë shpenzim apo taksë lidhur me emetimin e obligacioneve.</p> <p>Obligacionet do të emetohen me çmimin e emetimit (jepet përqindja e vlerës nominale të obligacioneve) dhe shuma nominale agregate e obligacioneve që do të emetohen do të specifikohet në fund të periudhës së ofertës. Shpërndarësit e autorizuar mund t’i ofrojnë obligacionet me çmimin e emetimit ose, nëse shpërndarësi i autorizuar ju faturon shpenzimet e veta, mund t’jua ofrojnë obligacionet për një shumë përkatëse që është më e lartë se çmimi i emetimit. Çdo shpenzim që ju kërkon shpërndarësi i autorizuar nuk është në përgjegjësi të emetuesit dhe, duhet t’i bëhet i ditur çdo investitori të mundshëm nga ana e shpërndarësit të autorizuar në momentin përkatës.</p>

<b>Cilët janë emrat dhe adresat e atyre që shpërndajnë obligacionet?</b>	Më datën e këtij prospekti, personat e renditur më poshtë janë personat të cilët, në dijeni të emetuesit, janë të autorizuar të ofrojnë dhe shpërndajnë obligacionet gjatë periudhës së ofertës (“shpërndarësit e autorizuar”): <b><u>[Këtu futet lista e plotë me emrat dhe adresat]</u></b>
--	---

## RUBRIKA 6 PËRSHKRIMI I EMETUESIT

### Informacion në lidhje me emetuesin

#### **[Një historik i shkurtër i zhvillimit të biznesit]**

### Veprimtaritë parësore

#### **[Një përshkrim i shkurtër i veprimtarive tregtare]**

### Anëtarët e këshillit të emetuesit

Anëtarët e këshillit të emetuesit dhe veprimtaritë parësore të tyre janë:

#### **[Lista me emrat dhe postet]**

Adresa e punës për secilin sa më lart është

#### **[Lista e adresave]**

Nuk ka asnjë konflikt të mundshëm interesi midis interesave vetjakë ose detyrave të tjera kundrejt të tretëve të anëtarëve të këshillit të emetuesit dhe detyrave që kanë kundrejt emetuesit.

### Qeverisja e shoqërisë

Emetuesi duhet të jetë në përputhje me standardet e qeverisjes së shoqërisë sipas **[këtu futet emri i autoritetit rregullator ose emërtimi i ligjit përkatës]**.

## RUBRIKA 7 TË DHËNA FINANCIARE

Raportet dhe llogaritë e publikuara nga emetuesi, kur të publikohen, do të jenë të gatshme për t’u vënë në dispozicion gjatë orarit normal të punës, në adresën tregtare të dhënë më lart.

Emetuesi ka caktuar **[emrat]** si ekspertë kontabël.

### Struktura e pronësisë

#### **[Lista e aksionarëve kryesorë të emetuesit]**

## **Përdorimi i fondeve**

Fondet e mbledhura nga emetimi i obligacioneve do të përdoren nga [emri i shoqërisë] për këto qëllime:

**[për të shlyer borxhin ekzistues, në funksion të kapitalit qarkullues të shoqërisë, etj.].**

**[Nëse është rasti, garancia ose kolaterali ekzistues që shoqëria u ka dhënë huadhënësve ekzistues do të çlirohet më datën e emetimit të obligacioneve].**

## **RUBRIKA 8 INFORMACION I PËRGJITHSHËM STRATEGJIK DHE PERSPEKTIVA PËR SHOQËRINË**

Konteksti

**[Përshkruhet shkurtimisht mjedisi aktual i biznesit]**

Strategjia për të ardhmen

**[Përshkruhen shkurtimisht planet e shoqërisë dhe si do t'i përdorë shoqëria fondet e emetimit]**

E ardhmja

**[Bëhen të ditura pritjet për zhvillimin e biznesit në të ardhmen dhe mendimi për mjedisin ekonomik]**

## **RUBRIKA 9 KUSHTET E SHITJES DHE KUFIZIMET**

**[Këtu futen kufizime që kanë lidhje me faktin që oferta është private dhe që personat të cilëve mund t'u bëhet oferta janë të kufizuar]**

## **RUBRIKA 10 TATIM-TAKSA**

**[Këtu perfshihen konsidera mbi trajtimin fiskal të obligacioneve. Sigurisht, informacioni për tatim-taksat është teknik dhe duhet verifikuar nga një ekspert i fushës]**

## **RUBRIKA 11 INFORMACIONE TË TJERA SHITESË (sipas rastit)**

### **1. Regjistrimi në bursë dhe pranimi për tregtim i obligacioneve**

Obligacionet shiten me ofertë private dhe nuk regjistrohen apo tregtohen në tregun zyrtar të Bursës.

### **2. Ndryshime të konsiderueshme ose me rëndësi materiale në pasqyra**

Nuk ka pasur asnjë ndryshim të konsiderueshëm të pozicionit financiar ose tregtues të shoqërisë pas datës **[data]** së periudhës së fundit të mbuluar nga të dhënat financiare të audituara të grupit. **[OSE fusni këtu informacionin përkatës për një ndryshim të tillë]**

### 3. **Konflikte gjyqësore**

Nuk ka asnjë proces shtetëror, ligjor ose arbitrazhi (përfshirë edhe procese të tilla që janë ende të papërfunduara apo që pritet të fillojnë) nga të cilat emetuesi, gjatë periudhës 12-mujore deri më datën e këtij prospekti, mund të ketë ose ka pasur në të shkuarën pasoja sa i takon pozicionit financiar apo rentabilitetit të emetuesit. **[OSE këtu futet informacion për një proces apo arbitrazh të tillë]**

### 4. **Dokumentet që mund të vihen në dispozicion për t'u parë**

Për periudhën 12-mujore duke filluar që më datën e këtij prospekti, kopje të dokumenteve të mëposhtme, do të vihen në dispozicion për t'u parë në selinë e regjistruar të emetuesit:

- a. Dokumentacioni themelues i emetuesit;
- b. Pasqyrat financiare të publikuara më të fundit të emetuesit, së bashku me raportet e auditimit ose shqyrtimit të përgatitura në lidhje me to;
- c. Kopje të këtij prospekti.

### 5. **Konflikti i interesit në ofertë**

Për aq sa është në dijeni emetuesi, asnjë person i përfshirë në ofertën e obligacioneve nuk ka asnjë interes me rëndësi materiale për ofertën. Nuk ka asnjë konflikt interesi me rëndësi materiale për ofertën e obligacioneve. **[ose të futet informacion për konfliktin e interesit]**

### 6. **Kontrata ose patenta madhore me rëndësi për shoqërinë**

**[të futen informacionet përkatëse]**

## **RUBRIKA 12 SHPËRNDARËSIT E AUTORIZUAR**

Emetuesi jep pëlqimin që ky prospekt në lidhje me ofertën private të obligacioneve, të shpërndahet nga ndërmjetës financiarë, në Shqipëri, ku përfshihen:

- i. Këshilltar investimi, bankë investimi, broker;
- ii. Banke kujdestare

“Kushtet për shpërndarësit e autorizuar”:

- a. I autorizuar të bëjë oferta të tilla;
- b. Të veprojë në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me rregullat dhe udhëzimet e organeve rregullatore (“**rregullat**”), përfshirë rregullat e publikuara nga AMF herë pas here, përfshirë ndër të tjera në çdo rast, rregullat në

lidhje me përshtatshmërinë e çdo investimi në obligacione nga çdo person dhe për vënien në dispozicion të informacioneve çdo investitori të mundshëm;

- c. Të veprojë në përputhje me kufizimet;
- d. Të sigurojë që çdo tarifë, komision, përfitim i çdo lloji, i paguar nga ky ndërmjetës financiar në lidhje me ofertën ose shitjen e obligacioneve të mos jetë në shkelje të rregullave dhe t'u bëhet qartësisht i ditur investitorëve faktikë ose të mundshëm;
- e. Të ketë të gjitha licencat, pëlqimet, miratimet dhe lejet e nevojshme në lidhje me kontaktimin e personave të interesuar për ofertat ose shitjet e obligacioneve në kuadër të këtyre rregullave, përfshirë edhe autorizimin nga AMF;
- f. Të veprojë në përputhje me rregullat dhe të marrë hapat e duhur në lidhje me rregullat kundër pastrimit të parave, kundër mitmarrjes, për parandalimin e korrupsionit dhe për verifikimin e identitetit të klientëve dhe të mos lejojë asnjë kërkesë për obligacione në rrethana ku ndërmjetësi financiar ka dyshime sa i takon burimit të fondeve të klientit;
- g. Të ruajë evidencat e identifikimit të investitorëve për të paktën një periudhë minimale sipas rregullave në fuqi dhe, sipas kërkesës dhe për aq sa e lejojnë rregullat, t'i vërë këto evidenca në dispozicion të emetuesit në mënyrë që t'u japë mundësi emetuesit, dorëzanësve dhe/ose administratorit të jetë në përputhje me rregullat kundër pastrimit të parave, kundër mitmarrjes, për parandalimin e korrupsionit dhe për verifikimin e identitetit të klientëve;
- h. Të njoftojë menjëherë emetuesin nëse në çdo moment ky shpërndarës i autorizuar vjen në dijeni ose dyshon se kanë vepruar ose mund të kenë vepruar në shkelje të rregullave ose të kushteve të kësaj pike dhe të marrë hapat e duhur për t'i ndrequr shkelje të tilla dhe për të ardhur në përputhje me rregullat dhe këtë pikë në çdo aspekt;
- i. Të mos japë asnjë informacion përveç se sa përmban ky dokument (me shtesat dhe ndryshimet e herëpashershme që mund të bëjë emetuesi) ose të mos thotë asgjë nga vetja lidhur me ofrimin ose shitjen e obligacioneve ose marrjen e interesit për to;
- j. Të jetë dakord që çdo komunikim në të cilin përfshin shpallje të publikuara nga emetuesit të jetë në përputhje me prospektin dhe (në çdo rast) duhet të jetë i drejtë, i qartë dhe jo keqorientues dhe në përputhje me rregullat.

### **Marrëdhënia mes investitorit dhe ndërmjetësve financiarë që do të shpërndajnë obligacionet**

Emetuesi nuk mban përgjegjësi për asnjë veprim të shpërndarësit të autorizuar, përfshirë përputhshmërinë e shpërndarësit të autorizuar me rregullat tregtare në fuqi apo me kërkesat e tjera rregullatore vendore ose kërkesat e tjera të ligjit për titujt lidhur me këtë ofertë.

Nëse keni ndër mend të blini ose nëse blini ndonjë obligacion nga një shpërndarës i autorizuar, ky veprim, si edhe ofertat dhe shitjet e bëra nga shpërndarësi i autorizuar, duhet

të jenë në përputhje me kushtet dhe marrëveshjet e tjera që keni me shpërndarësin e autorizuar, përfshirë çmimin, caktimet dhe shlyerjet. Emetuesi nuk është palë e marrëveshjeve rregulluese të tilla me ju në lidhje me ofertën ose shitjen e obligacioneve dhe, kështu, ky prospekt nuk përmban informacione të tilla. Nëse një shpërndarës i autorizuar bën një ofertë, ky shpërndarës i autorizuar u jep informacione investitorëve sipas kushteve të ofertës në momentin e bërjes së ofertës.

As emetuesi, as shpërndarësit e tjerë të autorizuar, nuk mbajnë përgjegjësi për informacione të tilla.

Ky prospekt është rreptësisht privat dhe rezervat dhe u shpërndahet një numri të kufizuar investitorësh e nuk mund t'i jepet askujt tjetër përveç se marrësit të synuar fillimisht dhe nuk mund të riprodhohet apo përdoret për qëllime të tjera.

### **RUBRIKA 13 PARALAJMËRIM PËR INVESTITORËT**

Obligacionet mund të mos jenë një investim i përshtatshëm për të gjithë investitorët. Duhet të vendosni vetë sa i takon përshtatshmërisë së çdo investimi duke pasur parasysh rrethanat tuaja. Në veçanti, mund t'ju interesojë të shqyrtoni, ose vetë ju, ose me ndihmën e këshilltarëve financiarë ose këshilltarëve tuaj të tjerë, nëse:

- a. Keni njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për të bërë një vlerësim të kuptimtë të obligacioneve, të mirave dhe risqeve të investimit në obligacione dhe informacioneve që përmban ky prospekt (dhe çdo shtesë e këtij prospekti);
- b. Keni mundësi përdorimi dhe njohuri për mjetet e duhura analitike për të vlerësuar, në kuadër të situatës së veçantë financiare, një investim në obligacione dhe efektin që do të kenë obligacionet në portofolin tuaj të përgjithshëm të investimeve;
- c. Keni burime financiare dhe likuiditet të mjaftueshëm për të përballuar risqet e investimit në obligacione përfshirë edhe rastin kur monedha e shlyerjes së principalit ose pagimit të interesit është tjetër nga monedha që përdorni zakonisht;
- d. I kuptoni me hollësi kushtet e obligacioneve dhe e njihni sjelljen e tregjeve financiare; dhe
- e. Jeni në gjendje të vlerësoni skenarët e mundshëm për faktorët ekonomikë, të normës së interesit dhe faktorë të tjerë që mund të prekin investimin tuaj dhe mundësinë tuaj për të përballuar risqet e vlefshme.

As ky prospekt, as çdo informacion tjetër që ju vihet në dispozicion në lidhje me ofertën e obligacioneve, nuk duhet konsideruar si rekomandim nga ana e emetuesit, investitorit nuk mund t'i rekomandohet se blerja e obligacionit është një vendim i mirë. Çdo blerës i mundshëm i obligacioneve bën mirë të vendosë vetë për aktualitetin e informacioneve që përmban ky prospekt dhe çdo blerje obligacionesh është mirë të mbështetet në gjykimin e investitorit. Shpërndarja e këtij prospekti dhe oferta e obligacioneve bëhet në bazë të legjislacionit shqiptar.



## ANEKSI 4

### PROSPEKTI TIP PËR OBLIGACIONE ME OFERTË PUBLIKE TË EMETUESIT

#### [Faqja e parë jep informacionin si më poshtë]

**Emri i emetuesit [shoqëria tregtare]**

**Shuma e emetimit**

Shembull: 200.000.000 lekë

**Lloji i obligacionit: (i garantuar, i pa garantuar, i konvertueshëm, etj.)**

Shembull: Obligacion i pagarrantuar

Shembull: Norma e interesit: 7%

Shembull: Afati i shlyerjes 5 vjet

**KËSHILLTARËT E EMETIMIT [bankë investimesh, këshilltar investimesh apo broker]**

[Emri dhe adresa]

**EKSPERTI/ËT KONTABËL**

[Emri dhe adresa]

**KËSHILLTARI JURIDIK**

[Emri dhe adresa]

**INVESTIMI NË KËTË OBLIGACION SHOQËROHET ME DISA RISQE. JU REKOMANDOHET TË MBANI PARASYSH FAKTORËT E PËRSHKRUAR NË RUBRIKËN 2 “FAKTORËT E RISKUT” TË KËTIJ PROSPEKTI.**

PROSPEKT, DATË [data]

"Me besimin tonë maksimal dhe në bazë të gjithë informacioneve dhe të dhënave për të cilat jemi në dijeni, deklarojmë se të gjitha të dhënat që përmbahen në këtë prospekt përbëjnë paraqitje të plotë dhe të vërtetë të aktiveve dhe pasiveve, fitimeve dhe humbjeve, gjendjes financiare dhe operacioneve të emetuesit, të të drejtave të lidhura me titujt për të cilët është përgatitur ky prospekt dhe se nga ai nuk janë hequr fakte dhe të dhëna të cilat mund të influencojnë në plotësinë dhe vërtetësinë e këtij prospekti."

**Nënshkruar nga [përfaqësuesi i autorizuar i emetuesit]**

**Kjo ofertë është ofertë publike dhe mund të nënshkruhet nga çdo preson fizik ose juridik në përputhje me kushtet e ofertës siç përshkruhet në këtë prospekt.**

**[Faqja e dytë ka përmbajtjen si më poshtë]**

**NJOFTIME TË RËNDËSISHME PËR INVESTITORIN**

Ky dokument (“**Prospekti**”) është hartuar në përputhje me rregullat në lidhje me përgatitjen e prospektit dhe lidhet me ofertën publike nga [emri i shoqërisë] (“**Emetuesi**”) të obligacionit të saj [specifikoni obligacionin, si për shembull obligacioni i pagarrantuar, i emetuar në lekë, me normë interesi 7%, me afat 5 vjet] me çmim [...për qind] e vlerës nominale.

Obligacionet janë instrumente borxhi lirisht të transferueshme dhe pritet të emetohen nga emetuesi më [**data**]. Vlera nominale e çdo obligacioni është [**10,000 lekë**]; shuma minimale e nënshkrimit për çdo investitor është [**shuma e nënshkrimit minimal në lekë**]; shuma nominale maksimale e obligacioneve që pritet të emetohen është [**200,000,000 lekë ne nr. Copë 20.000 obligacione**].

Obligacionet janë objekt i kërkesave të legjislacionit tatimor shqiptar.

Ky prospekt përmban informacione të rëndësishme për emetuesin dhe qëllimin për të cilin emetohen obligacionet. Ky prospekt përshkruan edhe risqet që lidhen me emetuesin dhe risqet që lidhen me investimin në obligacionet.

Ju rekomandohet ta lexoni dhe kuptoni plotësisht përmbajtjen e këtij prospekti përpara se të merrni ndonjë vendim për të investuar në obligacione.

***Përgjegjësia për informacionet që përmban ky prospekt***

Emetuesi pranon përgjegjësinë për informacionet që përmban ky prospekt. Informacioni që përmban ky prospekt përputhet me faktet dhe nuk lë pa përfshirë asnjë informacion që do të cenonte rëndësinë e këtij prospekti.

Kur informacionet kanë burim të tretë, këto informacione janë riprodhuar me saktësi dhe emetuesi është në gjendje të qartësojë informacionet e botuara nga ky i tretë, si dhe asnjë fakt nuk është lënë jashtë që do ta bënte të pasaktë apo keqorientues informacionin e riprodhuar. Burimi i informacioneve nga të tretë identifikohet.

**AMF ka konfirmuar vetëm që ky prospekt është në përputhje me kërkesat mbi emetimin e titujve sipas Ligjit nr.9879 “Për titujt” dhe Ligji nr.10158 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore” AMF nuk verifikon informacionet që përmban ky prospekt dhe nuk bën asnjë rekomandim për përshtatshmërinë e investimit në obligacione për asnjë person. Çdo investitor mban përgjegjësi vetë për vendimin e tij mbështetur në informacionet që përmban ky prospekt dhe, nëse ka dyshime, është mirë të konsultohet me një këshilltar profesional.**

Prospekti duhet të përmbajë rubrikat si më poshtë:

## RUBRIKA 1 – PËRMBLEDHJE

Kjo është një përmbledhje e të gjitha të dhënave që jepen më pas në këtë prospekt.

<b>Rubrika A – Hyrje</b>	
<b>A.1</b>	Kjo përmbledhje duhet konsideruar si hyrje e këtij prospekti. Çdo vendim për të investuar në <b>[këtu futet lloji i obligacionit (“obligacionet”)]</b> të <b>[emri i shoqërisë tregtare]</b> (“emetuesi”) duhet mbështetur në marrjen në konsideratë të këtij prospekti si një dokument i tërë nga ana e investitorit.
<b>A.2</b>	<p>(i) Emetuesi <b>[emri i shoqërisë tregtare]</b>, këshilltari i tij <b>[emri i këshilltarit nëse përdoret një këshilltar]</b> dhe çdo ndërmjetës financiar i emëruar për shitjen e obligacioneve <b>[emetuesi do të caktojë një ose më shumë agjentë të shitjes të përshkruar si shpërndarës të autorizuar]</b> jep pëlqimin për përdorimin e këtij prospekti në lidhje me këtë ofertë publike të obligacioneve, përfshirë çdo rishitje të mëposhme ose ofertë përfundimtare të obligacioneve nga ana e ndërmjetësve financiarë në Shqipëri gjatë periudhës që fillon nga data e këtij prospekti deri në <b>[këtu futet ora dhe data]</b> (“periudha e ofertës”)</p> <p>(ii) këshilltari; <b>[emri, nëse përdoret]</b></p> <p>(iii) çdo ndërmjetës financiar i emëruar dhe emri i të cilit publikohet më poshtë dhe identifikohet si shpërndarës i autorizuar (sipas përkufizimit të mëposhtëm) në lidhje me këtë ofertë publike;</p> <p><b>[Vini re: sa më poshtë i jep garanci investitorit se personi që bën ofertën është i licencuar nga AMF dhe i autorizuar nga emetuesi]</b></p> <p><i>Ne, <b>[emri/emrat e ndërmjetësve financiarë]</b>, i referohemi ofertës së [lloji i obligacioneve] (“obligacionet”)] të përshkruar në prospektin e datës <b>[data]</b> (“prospekti”) publikuar nga [emri i shoqërisë tregtare]. Duke marrë parasysh se emetuesi ofron të na japë pëlqimin për ta përdorur prospektin në lidhje me ofertën publike të obligacioneve në Shqipëri gjatë periudhës së ofertës në përputhje me kushtet (e vendosura në prospekt), përmes kësaj deklarate e pranojmë këtë ofertë të emetuesit. Konfirmojmë se jemi të licencuar nga AMF për të bërë këtë ofertë publike dhe se e përdorim prospektin në lidhje me bërjen e kësaj oferte publike.</i></p> <p><i>Ndërmjetësit financiarë të përmendur më lart, së bashku do të quhen këtu si “shpërndarës të autorizuar”.</i></p> <p><i>Përveçse sa thuhet më lart, emetuesi nuk ka autorizuar bërjen e një oferte publike</i></p>

	<i>nga asnjë person në asnjë rrethanë, dhe personave të tillë nuk u lejohet ta përdorin këtë prospekt lidhur me ndonjë ofertë obligacionesh. Oferta të tilla nuk bëhen në emër të emetuesit dhe emetuesi nuk mban asnjë përgjegjësi për veprime të personave të tillë që bëjnë oferta të tilla.</i>
--	---

<b>Rubrika B – Të dhëna për emetuesin</b>		
<b>B.1</b>	<b>Emri juridik dhe tregtar</b>	Emri juridik dhe tregtar i emetuesit është <b><u>[emri i shoqërisë]</u></b>
<b>B.2</b>	<b>Selia e regjistruar dhe forma juridike</b>	Emetuesi është shoqëri tregtare e themeluar dhe regjistruar në Shqipëri <b><u>[jepen të dhënat e autoritetit themelues dhe miratues]</u></b>
<b>B.3</b>	<b>Emrat e anëtarëve të këshillit dhe/ose administratorit</b>	<b>[Emrat dhe titujt e plotë të anëtarëve të këshillit dhe/ose administratorit]</b>
<b>B.4</b>	<b>Përshkrim i çdo trendi të ditur që prek emetuesin dhe dorëzanësin [nëse ka]</b>	
<b>B.5</b>	<b>Parashikime mbi fitime të ardhshme</b>	<b><u>[Nëse bëhen parashikime të fitimit, këto duhen verifikuar nga një auditues i aprovuar]</u></b>
<b>B.6</b>	<b>Konstatime nga raporti i ekspertit kontabël</b>	<b><u>[Thuhet nëse llogaritë ose pasqyrat financiare kanë qenë objekt i raportit me rezerva ose i vërejtjeve nga eksperti kontabël apo nga ndonjë autoritet tjetër]</u></b>
<b>B.7</b>	<b>Të dhëna financiare historike të përzgjedhura</b>	<p>Të dhënat e mëposhtme financiare të përmbledhura më datën e pasqyrave financiare dhe për secilin vit financiar të mbyllur, <b><u>[bëhen të ditura vitet]</u></b>.</p> <p>Nuk ka pasur asnjë ndryshim të konsiderueshëm në pozicionin financiar ose tregtues të emetuesit dhe nuk ka pasur ndryshime të padëshirueshme me rëndësi materiale të perspektivave të emetuesit, pas datës së pasqyrave financiare.</p> <p><b>Të dhënat financiare kryesore të konsoliduara të emetuesit</b></p>

		<p><b><u>[Këtu jepet një përmbledhje e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, bilancit dhe pasqyrës së flukseve monetare për tre vitet më të fundit. Nëse është e nevojshme, mund të jepen si lidhje pasqyrat financiare të plota.]</u></b></p>
--	--	--

		<p>Të dhënat e mëposhtme financiare përmbledhëse, për vitet financiare të mbyllura <b>[shënoni vitet]</b> janë nxjerrë, pa asnjë korrigjim me rëndësi materiale, nga pasqyrat financiare të emetuesit në lidhje me këto data dhe/ose periudha përkatëse, sipas rastit.</p> <p>Nuk ka pasur asnjë ndryshim të ndjeshëm në pozicionin financiar ose tregtues të <b>[emri i shoqërisë emetuese]</b> dhe shoqërive të saj të kontrolluara të konsoliduara në këto pasqyra, pas periudhës së fundit të mbuluar nga informacioni financiar (dhe nuk ka pasur asnjë ndryshim të padëshirueshëm negativ në perspektivat e <b>[emri i shoqërisë emetuese]</b> pas datës së pasqyrave financiare të fundit të publikuara dhe të audituara.</p> <p>Të dhënat financiare kryesore të konsoliduara të <b>[shoqërisë]</b></p> <p style="text-align: right;">Vitet e audituara të mbyllura [viti]                      [viti]</p> <p>PASH i konsoliduar Xhiro afariste. (Humbja)Fitimi nga veprimtaria e zakonshme para tatimit..... (Humbja)fitimi ushtrimor .....</p> <p style="text-align: right;">Bilanci i konsoliduar                      Vitet e audituara të mbyllura [viti]    [viti]</p> <p>AAGJ .....</p> <p>AASH .....</p> <p>Të pagueshme, brenda një viti .....</p> <p>Pasive ASH neto</p> <p>Aktive gjithsej</p> <p>Minus pasive korente</p> <p>Të pagueshme pas më shumë se një viti ..</p> <p>Pasive neto _ .....</p> <p>Pasqyra e konsoliduar e flukseve monetare</p> <p style="text-align: right;">Vitet e audituara të mbyllura [viti]                      [viti]</p> <p>Flukset dalëse neto nga veprimtaria e shfrytëzimit .....</p> <p>Flukset dalëse neto nga investimet financimet.</p> <p>Flukset dalëse neto për shpenzime kapitale..</p> <p>Flukset hyrëse neto nga financimi .....</p> <p>Rritje(ulje) në mjetet monetare në vit</p>
--	--	---

--	--	--

<b>B.8</b>	<b>Ngjarje të fundit të lidhura me vlerësimin e aftësisë paguese të emetuesit</b>	<b>[Identifikohen, nëse ka]</b>
<b>B.9</b>	<b>Përshkrim i shoqërisë tregtare</b>	<b>[Përshkrim i plotë i veprimtarisë tregtare të emetuesit]</b>
<b>B.10</b>	<b>Vlerësimi i aftësisë kredimarrëse (nëse ka)</b>	<b>[Nëse emetuesi ka një vlerësim kreditor, jepet këtu]</b>

<b>Rubrika C – Të dhëna për obligacionet</b>		
<b>C.1</b>	<b>Lloji dhe klasa e obligacioneve</b>	<b>[Obligacione pa garanci në lekë me normë interesi 7 për qind me afat 5 vjet]</b> do të emetohen më <b>[data]</b> (“data e emetimit”) në formë të dematerializuar. Vlera nominale e çdo obligacioni (që është shuma e përdorur në llogaritjen e pagesave të bëra për çdo obligacion) është 10.000 lekë. <b>[Nëse obligacionet janë të mbuluara me garanci ose dorëzani ose janë të konvertueshme, kjo duhet thënë këtu dhe të jepen disa të dhëna për këtë]</b> Numri Ndërkombëtar i Identifikimit të Letrave me Vlerë ose Numri Shqiptar i Identifikimit të Letrave me Vlerë për obligacionet është <b>[këtu futet numri, nëse ka]</b>
<b>C.2</b>	<b>Monedha e obligacionit</b>	Lekë (ALL) <b>[ose shprehet monedha përkatëse]</b>
<b>C.3</b>	<b>Kufizimet mbi kalimin e pronësisë mbi obligacionin</b>	<b>[Nëse ka kufizime të tilla; ose thuhet se nuk ka kufizime mbi kalimin lirisht të pronësisë së obligacioneve]</b>

C.4	Të drejtat e lidhura me obligacionin	<p><b>Statusi i obligacionit</b></p> <p>Obligacionet përbëjnë detyrime <b>[futet statusi, si për shembull pa garanci]</b> të emetuesit. Për rrjedhojë ato renditen pas obligacioneve <b>[futet fjala e duhur, si me garanci]</b>. Obligacionet renditen <i>pari passu</i> (pra, në mënyrë të barabartë) dhe pa përparësi mes tyre.</p> <p><b>[Nëse obligacionet janë të mbuluara me garanci ose dorëzani jepen të dhëna të garancisë ose dorëzani. Nëse ka një dorëzani të jashtëm, jepen të dhëna përfshirë pasqyrat financiare si në pikën B7 më lart]</b></p>
C.5		<p><b>Shlyerje fakultative përpara afatit nga emetuesi [nëse kjo është e mundshme, atëherë jepen kushtet përkatëse ]</b></p>
C.6	Komponenti derivativ i obligacionit	<p><b>[Shënoni nëse ka një të drejtë për shlyerje përpara afatit dhe në çfarë rrethanash]</b></p>
C.7	Regjistrimi në bursë dhe pranimi për tregtim	<p>Është paraqitur kërkesë për t'i regjistruar obligacionet në <i>Bursën Shqiptare</i>, në të cilën është konfirmuar se me përfundimin e emetimit obligacionet do të pranohen për të tregtim sipas rregullave të bursës.</p>

<b>Rubrika D Risqet kryesore</b>		
D.1	Risqet kryesore që janë specifike për emetuesin	<p><b>[Këtu futen risqet kryesore ndaj biznesit të emetuesit – duhet të jetë një seri e plotë e risqeve të biznesit]</b></p>
D.2	Risqet kryesore që janë specifike për obligacionet	<p>Investimi në obligacione përfshin riskun se ndryshimet e mëpasshme të normave të interesit në treg mund ta prekin negativisht vlerën e obligacioneve. Nëse rriten normat e interesit, atëherë norma e të ardhurës e pagueshme për obligacionet mund të bëhet më pak tërheqëse për investitorët.</p> <p>Jepen risqet e tjera.</p>



<b>D.3</b>	<b>Risqet kryesore lidhur me shitjen e obligacioneve përpara maturimit</b>	Nëse do të keni nevojë apo dëshirë t'i shisni obligacionet përpara maturimit, çmimi që do të merrni mund të jetë më i ulët se shuma që keni paguar për blerjen e obligacioneve në emetim.
------------	--	---

<b>Rubrika E – Të dhëna për ofertën</b>		
<b>E.1</b>	<b>Arsyet e ofertës dhe përdorimi i fondeve</b>	Oferta e obligacioneve bëhet <b><u>[arsyeja – në arsyet e zakonshme përfshihen: për të rritur numrin e burimeve të financimit të shoqërisë; për të shlyer borxhet ekzistuese të shoqërisë; në funksion të kapitalit qarkullues të shoqërisë].</u></b>
<b>E.2</b>	<b>Kushtet e ofertës</b>	<p>Oferta pritet të hapet më datën e këtij prospekti dhe të mbyllet në <b>[ora]</b> me orën e Tiranës më <b>[data]</b>, ose në një orë dhe datë të mëparshme që do të shpallet nga emetuesi.</p> <p>Obligacionet do të emetohen me çmimin e emetimit (jepet përqindja e vlerës nominale) dhe shuma nominale agregate e obligacioneve që do të emetohen do të specifikohet në shpalljen që do të publikojë emetuesi.</p> <p>Shpërndarësit e autorizuar mund t'i ofrojnë obligacionet me çmimin e emetimit (jepet përqindja e vlerës nominale të obligacioneve) ose, nëse shpërndarësi i autorizuar ju faturon shpenzimet e veta, mund t'ju ofrojnë obligacionet për një shumë përkatëse që është më e lartë se çmimi i emetimit. Për shembull, nëse banka, brokeri ose këshilltari juaj financiar ju kërkon të paguani shpenzimet e tregtimit, për shembull prej 1 për qind, atëherë obligacionin do t'ju ofrojnë kundrejt 101. Duhet të pyesni bankën, brokerin ose këshilltarin tuaj financiar se çfarë shpenzimesh do t'ju kërkojnë të mbuloni dhe, për rrjedhojë, çfarë çmimi ju ofrojnë dhe cilat do të jenë tarifat përkatëse nëse kërkesa juaj nuk del me sukses. Çdo shpenzim i tillë nuk është përgjegjësi e emetuesit. Kjo duhet t'i bëhet i ditur çdo investitori të mundshëm nga ana e shpërndarësit të autorizuar në momentin përkatës.</p> <p><b><u>[Vini re: kjo i jep mundësi shpërndarësit të autorizuar, bankës ose brokerit të shtojë një komision ose tarifë]</u></b></p>
<b>E.3</b>	<b>Nënshkrimi minimal</b>	Shuma minimale e nënshkrimit për investitor është për vlerën nominale prej <b><u>[për shembull, 200.000 lekë]</u></b> të obligacioneve në shpërndarje fillestare. Shuma minimale e obligacioneve që është e nevojshme për përfundimin e

		emetimit është <b>[për shembull 150.000.000 lekë]</b> shuma maksimale e obligacioneve që do të emetojë emetuesi sipas ofertës është <b>[për shembull 200.000.000 lekë]</b> si vlerë nominale agregate.
E.4	<b>Metodika e plotësimit të kërkesave me shkallë zvogëluese</b>	(Nëse është rasti) Në rast nënshkrimi të pamjaftueshëm metodika e plotësimit me shkallë zvogëluese do të jetë <b>[futet këtu]</b> .
E.5	<b>Interesat me rëndësi materiale për ofertën</b>	<b><u>[Këtu shprehet nëse ka interesa të veçanta; përndryshe thuhet se për aq sa është në dijeni emetuesi, asnjë person i përfshirë në emetimin/ofertën e obligacioneve nuk ka asnjë interes me rëndësi materiale për ofertën, përfshirë edhe interesa në konflikt.]</u></b>
E.6	<b>Shpenzimet e çmuara që i ngarkohen investitorit</b>	Emetuesi nuk do t'ju ngarkojë asnjë shpenzim apo taksë lidhur me kërkesën për obligacione apo blerjen e obligacioneve.  Por mund t'ju ngarkojë shpenzime shpërndarësi i autorizuar. Shpenzime të tilla janë jashtë kontrollit të emetuesit, nuk dihen nga emetuesi dhe duhet t'i bëhen të ditura çdo investitori të mundshëm nga ana e shpërndarësit të autorizuar në momentin përkatës. Ju rekomandohet të verifikoni nëse do t'ju ngarkohen pagesa të tilla pavarësisht nga suksesi i kërkesës.

## RUBRIKA 2 FAKTORËT E RISKUT

### Yield

Yield-i (pra, kthimi mbi obligacionet) i shprehur në këtë prospekt (shih Rubrikën 3 (*Informacion për obligacionet – Cili është yield-i i obligacioneve?*)) vlen vetëm për investimet e bëra me çmimin e emetimit (jo më pak ose më shumë, pra 100 për qind i çmimit) të obligacioneve. Nëse investoni në këto obligacione me një çmim që nuk është çmimi emetimit të obligacioneve, kthimi mbi investimin do të jetë i ndryshëm nga yield-i i shprehur në prospekt.

### Konvertimi në para nga shitja e obligacioneve përpara datës së parashikuar të maturimit

Nëse vendosni t'i shisni obligacionet në çdo moment përpara datës së maturimit, çmimi i marrë nga një shitje e tillë mund të jetë më i ulët se investimi fillestar që keni bërë. Faktorët që ndikojnë në çmim mund të përfshijnë, ndër të tjera, “oreksin” e tregut, inflacionin, kohën e shlyerjes, normat e interesit dhe pozicionin financiar aktual dhe një analizë të perspektivave të emetuesit në momentin përkatës.

**Luhatjet e normave të interesit dhe masat kontrolluese të bursës mund të ndikojnë negativisht në kthimin mbi investimet në obligacione dhe/ose vlerën e tregut të**

### obligacioneve.

Emetuesi do të paguajë principalin dhe interesin e obligacioneve [lekë]. Kjo paraqet disa risqe të caktuara lidhur me konvertimin valutor nëse veprimtaritë financiare i keni të shprehura kryesisht në një monedhë ose njësi monetare (“monedha e investitorit”) që nuk është [leku]. Këtu përfshihet risku se kursi i këmbimi valutor mund të ndryshojë ndjeshëm (përfshirë ndryshimet për shkak të zhvlerësimit të [lekut] apo rivlerësimit të monedhës së investitorit) dhe risku se autoritetet që kanë kompetencë mbi monedhën e investitorit mund të vendosin ose të modifikojnë masa kontrolluese. Fuqizimi i monedhës së investitorit në raport me [lekun] do ta ulte:

- a. Yield-in ekuivalent në monedhën e investitorit mbi obligacionet;
- b. Vlerën ekuivalente në monedhën e investitorit të principalit të pagueshëm mbi obligacionet; dhe
- c. Vlerën e tregut ekuivalente në monedhën e investitorit mbi obligacionet.

### Ndryshimet e shkallëve të inflacionit mund të prekin negativisht vlerën e obligacioneve

Obligacionet përfshijnë interes me normë fikse, pra jo duke iu referuar një indeksi bazë. Prandaj, ju rekomandohet të vëreni se me rritjen e normave të interesit, të ardhurat e pagueshme mbi obligacionet bëhen relativisht më pak tërheqëse dhe çmimi që mund të arrini nga shitja e obligacioneve mund të bjerë. Por kjo nuk ka asnjë ndikim mbi të ardhurat gjithsej që merrni më datën e maturimit të obligacioneve nëse do t’i mbani deri më këtë datë obligacionet. Gjithashtu, inflacioni e ul vlerën reale të obligacioneve me kalimin e kohës, çka mund të prekë atë që mund të blini me investimin tuaj në të ardhmen dhe mund ta bëjë normën fikse të pagueshme mbi obligacionet relativisht më pak tërheqëse në të ardhmen, çka cenon çmimin që mund të arrinit nga shitja e obligacioneve.

## RUBRIKA 3 INFORMACION PËR OBLIGACIONET

<p><b>Çfarë janë obligacionet?</b></p>	<p><b>[Obligacionet pa garanci në lekë me normë interesi 7 për qind me afat 5 vjet]</b> (“obligacionet”) janë instrumente të borxhit të emetuara nga <b>[emri i shoqërisë]</b> (“emetuesi”). Obligacionet janë objekt i “<i>kushteve të obligacioneve</i>” të cilat bëhen të ditura në Rubrikën 14 të këtij prospekti <b>[nëse zbatohen kushte të hollësishme]</b>. Obligacionet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>(a) i japin të drejtë mbajtësit të obligacionit të arkëtojnë interes me normë fikse interesi prej <b>[7 për qind në vit (i pagueshëm me dy këste të barabarta më datat të cdo viti)]</b>;</li> <li>(c) pritet të emetohen më <b>[data]</b> (“data e emetimit”) dhe të shlyhen plotësisht nga emetuesi më <b>[data]</b> (“data e maturimit”);</li> </ol>
--	--

	(d) por në rrethana të caktuara mund të shlyhen përpara datës së maturimit nëse emetuesi vendos kështu ose në rast mospërbushjeje të kushteve të obligacioneve.
<b>Kush i emeton obligacionet?</b>	Obligacionet emetohen nga <b>[emri i shoqërisë]</b> Shih Rubrikën 7 ( <i>Përshkrim i shoqërisë tregtare</i> ) për më shumë informacion.
<b>A garantohen obligacionet?</b>	<b>[Të shkruhet sipas rastit; në rastin e shembullit të përdorur në model]</b> Jo. Obligacionet nuk mbulohen me garanci.
<b>Për çfarë do të përdoren fondet e ardhura nga emetimi?</b>	Emetuesi do t'i përdorë fondet e emetimit për <b>[këtu shkruhet diçka si shlyerje e huamarrjeve ekzistuese dhe për kapital qarkullues i shoqërisë ose për qëllime të tjera]</b>
<b>Cila është norma e interesit?</b>	Norma e interesit e pagueshme mbi obligacionet do të jetë fikse deri më datën e maturimit prej <b>[7 për qind]</b> në vit. Norma e interesit e pagueshme mbi obligacionet është fikse për të gjithë kohëzgjatjen e obligacioneve. Pagesa e parë e interesit në lidhje me obligacionet do të bëhet më <b>[data]</b> . Pas pagesës së parë, interesi pritet të paguhet më <b>[datat]</b> çdo vit deri më datën e maturimit, përfshirë edhe këtë (nëse obligacionet nuk shlyhen më herët).
<b>Si llogaritet interesi i pagueshëm?</b>	Emetuesi do të paguajë një normë fikse vjetore interesi prej <b>[7 për qind]</b> në lidhje me obligacionet. Interesi do të jetë i pagueshëm në <b>[dy këste gjashtëmuajore]</b> . Pra, për çdo vlerë nominale obligacioni prej 10.000 lekë që do të blini, do të merrni <b>[shuma]</b> më <b>[data]</b> dhe <b>[shuma]</b> më <b>[data]</b> , pra çdo gjashtë muaj deri më datën e maturimit (nëse nuk do të shisni obligacionet ose nëse obligacionet nuk do të shlyhen përpara datës së maturimit).
<b>Sa është yield-i i obligacioneve?</b>	Në bazë të çmimit të emetimit të obligacioneve prej 100 për qind të vlerës nominale, yield-i fillestar (që është interesi që merret mbi obligacionet i shprehur si përqindje e vlerës nominale) i obligacioneve më datën e emetimit është <b>[7 për qind]</b> si normë vjetore. Ky yield fillestar nuk është tregues i yield-it të ardhshëm.
<b>A do të mund t'i tregtoj obligacionet?</b>	Obligacionet do të regjistrohen në Bursën Shqiptare dhe mund të blihen ose shiten përmes një brokeri që është anëtar i bursës sipas rregullave të bursës.

<b>A kanë vlerësim kreditor obligacionet?</b>	<b><u>[Futet teksti përkatës – për shembull: Jo, obligacionet nuk do të vlerësohen në emetim nga asnjë agjenci e vlerësimit kreditor. Hë për hë, emetuesi nuk ka ndër mend të kërkojë vlerësim kreditor nga asnjë agjenci e vlerësimit kreditor. OSE këtu futen të dhënat e vlerësimit kreditor]</u></b>
<b>A kanë të drejta votimi obligacionet?</b>	Mbajtësit e obligacioneve kanë disa të drejta të caktuara për të votuar në mbledhjet e mbajtësve të obligacioneve, por nuk kanë të drejtë vote në asamblenë e aksionarëve të emetuesit, dorëzanësve apo anëtarëve të tjerë të grupit. Kushtet e obligacioneve përmbajnë dispozita për thirrjen e mbledhjeve të mbajtësve të obligacioneve për të shqyrtuar çështje që prekin interesat e tyre në përgjithësi. Këto dispozita u japin mundësi shumicave të madhësive të caktuara t'u imponojnë vullnetin e tyre të gjithë mbajtësve të obligacioneve përfshirë edhe ata mbajtës obligacionesh që nuk kanë marrë pjesë dhe nuk kanë votuar në mbledhjen përkatëse dhe mbajtës obligacionesh që kanë votuar ndryshe nga shumica.
<b>Kush i përfaqëson interesat e mbajtësve të obligacioneve?</b>	Agjenti i mbajtësve të obligacioneve duhet të jetë bankë e licencuar nga Banka e Shqipërisë ose broker në tituj i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe do të përzgjidhet nga një listë prej jo më shumë se pesë kandidatësh të sugjeruar nga emetuesi.. <b>Agjenti përfaqëson interesat e mbajtësve të obligacioneve.</b> Detyrimet kryesore të emetuesit (siç është detyrimi për të paguar interes dhe për të shlyer obligacionet) shqyrtohen nga agjenti i mbajtësve të obligacioneve, roli i të cilit është të mbrojë interesat e mbajtësve [ <b>individualë</b> ] të obligacioneve.
<b>Si të bëj kërkesë për obligacionet?</b>	Për informacion si të bëni kërkesë për obligacionet, shih Rubrikën 4 ( <i>Kalendari i ofertës dhe datat kryesore</i> ) dhe Rubrikën 5 ( <i>Si të bëjmë kërkesë për obligacionet</i> ).
<b>Po sikur të kem pyetje të tjera?</b>	Nëse nuk jeni të qartë në lidhje me ndonjë çështje apo nëse jeni të sigurt nëse obligacionet janë një investim i përshtatshëm, është mirë të kërkonti këshilla profesionale nga banka, brokeri, avokati, kontabilisti ose këshilltari juaj i pavarur financiar përpara se të merrni vendim nëse duhet ose jo të investoni.

## RUBRIKA 4 KALENDARI I OFERTËS DHE DATAT KRYESORE

### Datat kryesore të ofertës

Fillimi i periudhës së ofertës

**[Këtu futet data përkatëse]**

Fundi i periudhës së ofertës

**[Këtu futet data përkatëse]**

Shpallja (konfirmimi i shumës nominale gjithsej të obligacioneve që do të emetohen)

**[Këtu futet data përkatëse]**

Data e emetimit	<b><u>[Këtu futet data përkatëse]</u></b>
<b>Datat kryesore për obligacionet</b>	
Data e parë e pagimit të interesit	<b><u>[Këtu futet data përkatëse]</u></b>
Data e maturimit	<b><u>[Këtu futet data përkatëse]</u></b>

Interesi planifikohet të paguhet më **[datat gjashtëmuajore të pagimit të interesit – tregoni datat]**, deri më datën e maturimit ose deri më datën e shlyerjes përpara afatit. Pagesa e parë e interesit do të bëhet më **[data]**. Nëse ndonjë prej këtyre datave nuk është ditë pune, atëherë pagesa e interesit do të bëhet ditën e parë të ardhshme të punës pa akumuluar interes shtesë.

Ky prospekt mund të përdoret vetëm nga shpërndarësit e autorizuar të përmendur në këtë prospekt në funksion të ofrimit të obligacioneve gjatë periudhës së ofertës; në asnjë rast pas fundit të periudhës së ofertës. Asnjë person që nuk është shpërndarës i autorizuar nuk lejohet të përpunojë kërkesa në emër të një subjekti kërkues.

## RUBRIKA 5 SI TË BËJMË KËRKESË PËR OBLIGACIONET

<b>Si të bëj kërkesë për obligacionet?</b>	Kërkesat mund të bëhen vetëm përmes formularit të kërkesës që jepet si bashkëlidhje dhe është pjesë e këtij prospekti. Kërkesat e bëra në mënyra të tjera nuk do të pranohen
<b>Si dhe me çfarë kushtesh do të më caktohen obligacionet?</b>	Kërkesat për të blerë obligacione nuk mund t'i paraqiten drejtpërdrejt <b><u>[emri i emetuesit]</u></b> . Obligacionet do të shpërndahen nëpërmjet shpërndarësit të autorizuar, nga i cili do të merrni informacionin përkatës. Duhet të viheni në kontakt me bankën, brokerin ose ndërmjetësin tuaj financiar për të diskutuar masat organizuese për procesin e kërkesës që mund të përdorni. Emetuesi nuk është palë e rregullimeve të tilla midis jush dhe ndërmjetësve përkatës financiarë (" <b><u>shpërndarësit e autorizuar</u></b> "). Prandaj, këtë informacion duhet ta merrni nga shpërndarësi përkatës i autorizuar. Ngaqë nuk është palë në marrëdhëniet që mund të keni me ndonjë shpërndarës të autorizuar, emetuesi nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi përpara jush për informacionet që ju jep shpërndarësi i autorizuar.

<p><b>Sa obligacione do t'u emetohen investitorëve?</b></p>	<p>Shuma gjithsej e obligacioneve që do të emetohen mund të varet nga shuma e obligacioneve për të cilat merren oferta orientuese për të blerë obligacione gjatë periudhës së ofertës. Kjo shumë gjithsej do të specifikohet në një shpallje që synon të publikojë emetuesi</p> <p><b><u>[këtu përcaktoni si dhe ku do të bëhet shpallja].</u></b> Shuma nominale minimale e obligacioneve të pranuar për plotësimin e ofertës do të jetë <b><u>[këtu futet një shifër, si për shembull 150.000.000 lekë].</u></b> Shuma nominale maksimale e obligacioneve që do të emetohen do të jetë <b><u>[këtu futet një shifër, si për shembull 200.000.000 lekë].</u></b></p>
<p><b>Si dhe kur duhet të bëj pagesën për obligacionet që më janë caktuar dhe kur do të më lëvrohen ato?</b></p>	<p>Do të merrni njoftim nga shpërndarësi i autorizuar për sa i takon obligacioneve që do t'ju caktohen (nëse ka) dhe se si do t'ju lëvrohen obligacionet përkundrejt pagesës.</p>
<p><b>Kur mund t'i ofrojë për shitje obligacionet shpërndarësi i autorizuar?</b></p>	<p>Oferta e obligacioneve mund të bëhet nga <b><u>[këshilltari, nëse ka, dhe]</u></b> shpërndarësit e tjerë të autorizuar gatë periudhës që nga data e këtij prospekti deri në <b><u>[ora dhe data]</u></b> (“<b>periudha e ofertës</b>”), ose një orë ose datë më e mëparshme siç do të bihet dakord midis emetuesit.</p>
<p><b>A ekziston mundësia që të mos më jepet numri i obligacioneve që kam kërkuar? A do të më kthehet pjesa e mbetur e parave që kam paguar?</b></p>	<p>Mund të mos ju caktohen të gjitha (ose asnjë) prej obligacioneve për të cilat keni bërë kërkesë. Për shembull, kjo mund të ndodhë nëse shuma gjithsej e porosive për obligacione e kalon numrin e obligacioneve për emetim. Nuk do të ketë kthim parash sepse nuk do t'ju kërkohej të paguani për obligacionet deri në momentin kur do të jenë pranuar kërkesat për obligacione dhe kur t'ju jenë caktuar obligacione.</p>
<p><b>A ka një shumë minimale apo maksimale obligacionesh për të cilat mund të bëj kërkesë?</b></p>	<p>Shuma minimale e kërkesës për çdo investitor është <b><u>[për shembull 200.000 lekë].</u></b> Shuma nominale maksimale agregate e obligacioneve që pritet të emetohen është <b><u>[për shembull 200.000.000 lekë].</u></b></p>
<p><b>Si dhe kur do të bëhen publike rezultatet e ofertës së obligacioneve?</b></p>	<p>Rezultatet e ofertës së obligacioneve do të bëhen publike në shpalljen që do të publikohet <b><u>[këtu futet të dhënat se si dhe kur].</u></b></p>
<p><b>Kur dhe si do të informohem se sa obligacione më janë caktuar?</b></p>	<p>Do të merrni njoftim nga shpërndarësi i autorizuar përkatës për sa i takon obligacioneve që do t'ju caktohen (nëse ka) në përputhje me rregullimet që keni me shpërndarësin e autorizuar.</p>

<p><b>Kur do të regjistrohen obligacionet e mira pranë kujdestarit/regjistrarit?</b></p>	<p>Obligacionet nuk kanë formë materiale dhe nuk do të marrin një certifikatë. Do të marrin informacion nga kujdestari/regjistrari pasi të jenë regjistruar obligacionet tuaja.</p>
<p><b>Cila është vlera e shpenzimeve dhe tatimeve që do të më ngarkohen në mënyrë specifike?</b></p>	<p>Emetuesi nuk do t'ju ngarkojë asnjë shpenzim apo taksë lidhur me emetimin e obligacioneve.</p> <p>Obligacionet do të emetohen me çmimin e emetimit (jepet përqindja e vlerës nominale të obligacioneve) dhe shuma nominale agregate e obligacioneve që do të emetohen do të specifikohet në shpalljen që do të publikojë emetuesi në fund të periudhës së ofertës. Shpërndarësit e autorizuar mund t'i ofrojnë obligacionet me çmimin e emetimit (jepet përqindja e vlerës nominale të obligacioneve) ose, nëse shpërndarësi i autorizuar ju faturon shpenzimet e veta, mund t'ju ofrojnë obligacionet për një shumë përkatëse që është më e lartë se çmimi i emetimit. Duhet të pyesni bankën, brokerin ose këshilltarin tuaj financiar se çfarë shpenzimesh do t'ju kërkojnë të mbuloni dhe, për rrjedhojë, çfarë çmimi ju ofrojnë dhe nëse do të ketë ndonjë tarifë për të paguar pavarësisht nëse kërkesa juaj del ose jo me sukses. Çdo shpenzim i tillë që ju kërkon shpërndarësi i autorizuar të mbuloni është jashtë kontrollit të emetuesit, nuk dihet nga emetuesi dhe duhet t'i bëhet i ditur çdo investitori të mundshëm nga ana e shpërndarësit të autorizuar në momentin përkatës</p>
<p><b>Cilët janë emrat dhe adresat e atyre që shpërndajnë obligacionet?</b></p>	<p>Më datën e këtij prospekti, personat e renditur më poshtë janë personat të cilët, në dijeni të emetuesit, janë të autorizuar të ofrojnë dhe shpërndajnë obligacionet gjatë periudhës së ofertës ("shpërndarësit e autorizuar"): <b><u>[Këtu futet lista me emrat dhe adresat]</u></b></p>

## RUBRIKA 6 PËRSHKRIMI I EMETUESIT

### Informacion në lidhje me emetuesin

#### **[Një historik i shkurtër i zhvillimit të biznesit]**

### Veprimtaritë parësore

#### **[Një përshkrim i shkurtër i veprimtarive tregtare]**

### Anëtarët e këshillit të emetuesit

Anëtarët e këshillit të emetuesit dhe veprimtaritë parësore të tyre janë:



**[Lista me emrat dhe postet]**

Adresa e punës për secilin sa më lart është

**[Lista e adresave]**

Nuk ka asnjë konflikt të mundshëm interesi midis interesave vetjakë ose detyrave të tjera kundrejt të tretëve të anëtarëve të këshillit të emetuesit dhe detyrave që kanë kundrejt emetuesit.

**Qeverisja e shoqërisë**

Emetuesi duhet të jetë në përputhje me standardet e qeverisjes së shoqërisë sipas **[këtu futet emri i autoritetit rregullator ose emërtimi i ligjit përkatës]**.

**RUBRIKA 7 TË DHËNA FINANCIARE**

Raportet dhe llogaritë e publikuara nga emetuesi, kur të publikohen, do të jenë të gatshme për t'u vënë në dispozicion gjatë orarit normal të punës, në adresën tregtare të dhënë më lart.

Emetuesi ka caktuar **[emrat]** si ekspertë kontabël.

**Struktura e pronësisë****[Lista e aksionarëve kryesorë të emetuesit]****Përdorimi i fondeve**

Fondet e mbledhura nga emetimi i obligacioneve do të përdoren nga [emri i shoqërisë] për këto qëllime:

**[për të shlyer borxhin ekzistues; në funksion të kapitalit qarkullues të shoqërisë].**

**[Nëse është rasti, garancia ose kolaterali ekzistues që shoqëria u ka dhënë huadhënësve ekzistues do të çlirohet më datën e emetimit të obligacioneve].**

**RUBRIKA 8 INFORMACION I PËRGJITHSHËM STRATEGJIK DHE PERSPEKTIVA PËR SHOQËRINË**

Konteksti

**[Përshkruhet shkurtimisht mjedisi aktual i biznesit]**

Strategjia për të ardhmen

**[Përshkruhen shkurtimisht planet e shoqërisë dhe si do t'i përdorë shoqëria fondet e emetimit]**

E ardhmja

**[Bëhen të ditura pritjet për zhvillimin e biznesit në të ardhmen dhe mendimi për mjedisin ekonomik]**

## **RUBRIKA 9 KUSHTET E SHITJES DHE KUFIZIMET**

**[Këtu futen kufizime që kanë lidhje me ofertën edhe pse oferta është ofertë publike dhe që personat të cilëve mund t'u bëhet oferta janë të kufizuar për shembull investitorët e huaj nëse oferta është e hapur vetëm për shtetasit shqiptarë]**

## **RUBRIKA 10 TATIM-TAKSA**

**[Këtu përfshihen konsidera mbi trajtimin fiskal të obligacioneve. Sigurisht, informacioni për tatim-taksat është teknik dhe duhet verifikuar nga një ekspert i fushës]**

## **RUBRIKA 11 INFORMACIONE TË TJERA SHITESË [sipas rastit]**

### **1. Regjistrimi në bursë dhe pranimi për tregtim i obligacioneve**

Është paraqitur kërkesë për t'i regjistruar obligacionet në Bursën Shqiptare.

### **2. Ndryshime të konsiderueshme ose me rëndësi materiale në pasqyra**

Nuk ka pasur asnjë ndryshim të konsiderueshëm të pozicionit financiar ose tregtues të shoqërisë pas datës **[data]** së periudhës së fundit të mbuluar nga të dhënat financiare të audituara të grupit. **[OSE fusni këtu informacionin përkatës për një ndryshim të tillë]**

### **3. Konfliktet gjyqësore**

Nuk ka asnjë proces shtetëror, ligjor ose arbitrazhi (përfshirë edhe procese të tilla që janë ende të papërfunduara apo që pritet të fillojnë) nga të cilat emetuesi, gjatë periudhës 12-mujore deri më datën e këtij prospekti, mund të ketë ose ka pasur në të shkuarën pasoja sa i takon pozicionit financiar apo rentabilitetit të emetuesit. **[ose këtu futet informacion për një proces apo arbitrazh të tillë]**

### **4. Dokumentet që mund të vihen në dispozicion për t'u parë**

Për periudhën 12-mujore duke filluar që më datën e këtij prospekti, kopje të dokumenteve të mëposhtme, me t'u publikuar, do të vihen në dispozicion për t'u parë në selinë e regjistruar të emetuesit:

- a) Dokumentacioni themelues i emetuesit;
- b) pasqyrat financiare të publikuara më të fundit (nëse ka) të emetuesit, së bashku me raportet e auditimit ose shqyrtimit të përgatitura në lidhje me to;
- c) kopje të këtij prospekti.

#### 5. Konflikti i interesit në ofertë

Për aq sa është në dijeni emetuesi, asnjë person i përfshirë në ofertën e obligacioneve nuk ka asnjë interes me rëndësi materiale për ofertën. Nuk ka asnjë konflikt interesi me rëndësi materiale për ofertën e obligacioneve. **[ose të futet informacion për konfliktin e interesit]**

#### 6. Kontrata ose patenta madhore me rëndësi për shoqërinë

**[të futen informacionet përkatëse]**

### RUBRIKA 12 SHPËRNDARËSIT E AUTORIZUAR

Emetuesi jep pëlqimin që ky prospekt në lidhje me ofertën publike të obligacioneve, të shpërndahet nga ndërmjetës financiarë, në Shqipëri, ku përfshihen:

- i. Këshilltar investimi, bankë investimi, broker;
- ii. Bankë kujdestare.

“Kushtet për shpërndarësit e autorizuar”:

- a. I autorizuar të bëjë oferta të tilla;
- b. Të veprojë në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me rregullat dhe udhëzimet e organeve rregullatore (“**rregullat**”), përfshirë rregullat e publikuara nga AMF-ja herë pas here, përfshirë ndër të tjera në çdo rast, rregullat në lidhje me përshtatshmërinë e çdo investimi në obligacione nga çdo person dhe për vënien në dispozicion të informacioneve çdo investitori të mundshëm;
- c. Të veprojë në përputhje me kufizimet;
- d. Të sigurojë që çdo tarifë, komision, përfitim i çdo lloji, i paguar nga ky ndërmjetës financiar në lidhje me ofertën ose shitjen e obligacioneve të mos jetë në shkelje të

rregullave dhe t'u bëhet qartësisht i ditur investitorëve faktikë ose të mundshëm;

- e. Të ketë të gjitha licencat, pëlqimet, miratimet dhe lejet e nevojshme në lidhje me kontaktimin e personave të interesuar për ofertat ose shitjet e obligacioneve në kuadër të këtyre rregullave, përfshirë edhe autorizimin nga AMF;
- f. Të veprojë në përputhje me rregullat dhe të marrë hapat e duhur në lidhje me rregullat kundër pastrimit të parave, kundër mitmarrjes, për parandalimin e korrupsionit dhe për verifikimin e identitetit të klientëve dhe të mos lejojë asnjë kërkesë për obligacione në rrethana ku ndërmjetësi financiar ka dyshime sa i takon burimit të fondeve të klientit;
- g. Të ruajë evidencat e identifikimit të investitorëve për të paktën një periudhë minimale sipas rregullave në fuqi dhe, sipas kërkesës dhe për aq sa e lejojnë rregullat, t'i vërë këto evidenca në dispozicion të emetuesit në mënyrë që t'u japë mundësi emetuesit, dorëzanësve dhe/ose administratorit të jetë në përputhje me rregullat kundër pastrimit të parave, kundër mitmarrjes, për parandalimin e korrupsionit dhe për verifikimin e identitetit të klientëve;
- h. Të njoftojë menjëherë emetuesin nëse në çdo moment ky shpërndarës i autorizuar vjen në dijeni ose dyshon se kanë vepruar ose mund të kenë vepruar në shkelje të rregullave ose të kushteve të kësaj pike dhe të marrë hapat e duhur për t'i ndrequr shkelje të tilla dhe për të ardhur në përputhje me rregullat dhe këtë pikë në çdo aspekt;
- i. Të mos japë asnjë informacion përveç se sa përmban ky dokument (me shtesat dhe ndryshimet e herëpashershme që mund të bëjë emetuesi) ose të mos thotë asgjë nga vetja lidhur me ofrimin ose shitjen e obligacioneve ose marrjen e interesit për to;
- j. Të jetë dakord që çdo komunikim në të cilin përfshin shpallje të publikuara nga emetuesit të jetë në përputhje me prospektin dhe (në çdo rast) duhet të jetë i drejtë, i qartë dhe jo keqorientues dhe në përputhje me rregullat.

### **Marrëdhënia mes investitorit dhe ndërmjetësve financiarë që do të shpërndajnë obligacionet**

Emetuesi nuk mban përgjegjësi për asnjë veprim të shpërndarësit të autorizuar, përfshirë përputhshmërinë e shpërndarësit të autorizuar me rregullat tregtare në fuqi apo me kërkesat e tjera rregullatore vendore ose kërkesat e tjera të ligjit për titujt lidhur me këtë ofertë.

Nëse keni ndër mend të blini ose nëse blini ndonjë obligacion nga një shpërndarës i autorizuar, ky veprim, si edhe ofertat dhe shitjet e obligacioneve nga shpërndarësi i autorizuar, duhet të jenë në përputhje me kushtet dhe marrëveshjet e tjera që keni me shpërndarësin e autorizuar, përfshirë çmimin, caktimet dhe shlyerjet. Emetuesi nuk është palë e marrëveshjeve rregulluese të tilla me ju në lidhje me ofertën ose shitjen e obligacioneve dhe, kështu, ky prospekt nuk

përmban informacione të tilla. Nëse një shpërndarës i autorizuar bën një ofertë, ky shpërndarës i autorizuar u jep informacione investitorëve sipas kushteve të ofertës në momentin e bërjes së ofertës.

As emetuesi, as shpërndarësit e tjerë të autorizuar, nuk mbajnë përgjegjësi për informacione të tilla.

### **RUBRIKA 13 PARALAJMËRIM PËR INVESTITORËT**

Obligacionet mund të mos jenë një investim i përshtatshëm për të gjithë investitorët. Duhet të vendosni vetë sa i takon përshtatshmërisë së çdo investimi duke pasur parasysh rrethanat tuaja. Në veçanti, mund t'ju interesojë të shqyrtoni, ose vetë ju, ose me ndihmën e këshilltarëve financiarë ose këshilltarëve tuaj të tjerë, nëse:

- a. Keni njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për të bërë një vlerësim të kuptimtë të obligacioneve, të mirave dhe risqeve të investimit në obligacione dhe informacioneve që përmban ky prospekt (dhe çdo shtesë e këtij prospekti);
- b. keni mundësi përdorimi dhe njohuri për mjetet e duhura analitike për të vlerësuar, në kuadër të situatës së veçantë financiare, një investim në obligacione dhe efektin që do të kenë obligacionet në portofolin tuaj të përgjithshëm të investimeve;
- c. Keni burime financiare dhe likuiditet të mjaftueshëm për të përballuar risqet e investimit në obligacione përfshirë edhe rastin kur monedha e shlyerjes së principalit ose pagimit të interesit është tjetër nga monedha që përdorni zakonisht;
- d. I kuptoni me hollësi kushtet e obligacioneve dhe e njihni sjelljen e tregjeve financiare; dhe
- e. Jeni në gjendje të vlerësoni skenarët e mundshëm për faktorët ekonomikë, të normës së interesit dhe faktorë të tjerë që mund të prekin investimin tuaj dhe mundësinë tuaj për të përballuar risqet e vlefshme.

As ky prospekt, as çdo informacion tjetër që ju vihet në dispozicion në lidhje me ofertën e obligacioneve, nuk duhet konsideruar si rekomandim nga ana e emetuesit, investitorit nuk mund t'i rekomandohet se blerja e obligacionit është një vendim i mirë. Çdo blerës i mundshëm i obligacioneve bën mirë të vendosë vetë për aktualitetin e informacioneve që përmban ky prospekt dhe çdo blerje obligacionesh është mirë të mbështetet në gjykimin e investitorit. Shpërndarja e këtij prospekti dhe oferta e obligacioneve bëhet në bazë të legjisllacionit shqiptar.



## ANEKSI 5

### FORMULARI I KËRKESËS PËR INVESTIM NË NJË EMETIM TË RI OBLIGACIONESH TREGTARE

**[ky formular kërkesë duhet të jetë pjesë integrale e prospektit]**

**EMRI I EMETUESIT [SHOQËRIA TREGTARE]**

**SHUMA E EMETIMIT**

SEMBULL: 200.000.000 LEKË

**LLOJI I OBLIGACIONIT: (I MBULUAR, ME GARANCI, PA GARANCI, I NËNRENDITUR)**

SEMBULL: HUA PA GARANCI

SEMBULL: NORMA E INTERESIT: 7%

SEMBULL: AFATI I SHLYERJES 5 VJET

Unë/ne.....**[emri i individit ose emri i investitorit institucional<sup>1</sup> ose i kujdestarit të licencuar<sup>2</sup>]**

**Adresa, të dhënat e kontaktit dhe dokumenti i identifikimit**

.....

përmes kësaj kërkesë kërkojmë të nënshkruajmë

..... lekë të huasë pa garanci të **[shoqëria tregtare]** me normë interesi 7% me afat shlyerjeje 5 vjet (investim minimal .....000 lekë dhe më pas me shumëfisha të shumës .....000 lekë)

Kjo kërkesë bëhet nëpërmjet (emri dhe adresa e shpërndarësit të autorizuar)

.....

Janë paguar .....’000 lekë në lidhje me nënshkrimin në llogarinë e posaçme të nënshkrimit në bankën marrëse.

**[Emri i bankës, numri dhe të dhënat e llogarisë]**

<sup>1</sup> Nëse është investitor institucional, jepen të dhënat e regjistrimit të licencës nga autoriteti përkatës.

<sup>2</sup> Nëse është një institucion që kërkon që investimet të mbahen pranë një depozitari, jepen të dhënat e regjistrimit të licencës nga autoriteti përkatës.

**Unë/ne e kuptoj(më) se kërkesat për investim në emetimin e mësipërm të letrave me vlerë mund të bëhet vetëm duke përdorur këtë formular kërkesë; dhe se kërkesat e bëra në mënyra të tjera nuk do të pranohen.**

**Unë/ne e kuptoj(më) se kjo ofertë është e hapur vetëm për banorë të Republikës së Shqipërisë [nëse është kështu, ose mund të shkruhen kufizimet e tjera për subjektet kërkuese]**

Shpërndarësi i autorizuar m'i/na i ka shpjeguar të mirat ose të këqijat e të investuarit në obligacione dhe më/na ka dhënë një kopje të udhëzuesit zyrtar drejtuar investitorëve “pyetjet që bëhen më shpesh”. Shpërndarësi i autorizuar do të marrë ( $x\%$ ) komision siç kemi rënë dakord me shpërndarësin e autorizuar.

Mua/neve më/na është dhënë një kopje e prospektin për emetimin e lartpërmendur dhe i kam/kemi lexuar kushtet dhe risqet e përmendura në të.

Mua/neve më/na është dhënë një kopje e dokumentit “pyetje që bëhen më shpesh”.

Unë/ne e kuptoj(më) se mund të mos më/na caktohet sasia e plotë për të cilën është bërë nënshkrimi dhe, nëse oferta merr nënshkrime të tepërta, mund të më/na caktohet një sasi më e pakët e zvogëluar sipas metodës që tregohet në prospekt.

Unë/ne e kuptoj(më) se do të njoftohem(i) nga shpërndarësi i autorizuar lidhur me sasinë që më/na është caktuar pas mbylljes së ofertës.

Unë/ne e kuptoj(më) se obligacionet kur të emetohen do të jenë në emrin e nënshkruesit **individ ose institucional** në formë të dematerializuar; se nuk do të lëshohen certifikata në letër dhe se do të marr(im) njoftim kur të mbyllet oferta.

*[Sa më poshtë nuk bën pjesë në formularin e kërkesës. Njoftimi që i jepet investitorit duhet të përmbajë udhëzime se çfarë mund të presë investitori dhe ku mund të gjejë informacione të mëtejshme. Për shembull:*

- *Kur do të merren pagesat e interesit*
- *Çfarë informacionesh të rregullta dhe të tjera mund të presë investitori*
- *Si të kontaktohet kujdestari/regjistruesi dhe si të ndryshohet shënimi në regjistër nëse del nevoja (për shembull, kur ka ndryshim adrese)*
- *A mund të shiten obligacionet dhe si*
- *Nëse obligacionet do të regjistrohen në bursë, si mund të gjendet çmimi*
- *Çfarë duhet bërë nëse investitori do të donte ta kthente më herët obligacionin*

*AMF ka tashmë kërkesa për këtë të cilat mund të përfshihen këtu]*

Nënshkruar

**[emri i individit]**

ose

**[emri i personit të autorizuar të investitorit institucional ose depozitarit me vulën e shoqërisë]**

**Formulari i plotësuar i kërkesës duhet dorëzuar (vetëm gjatë orarit normal të punës) në adresën e shpërndarësit të autorizuar ose këshilltarit të emetimit ose bankës marrëse në mënyrë që të merret jo më vonë se [ora] më [data].**

[Këtu futet lista e adresave ku të dërgohet formulari i kërkesës]

.....

.....



## ANEKSI 6

### Ç'DUHET TË DIMË NË LIDHJE ME INVESTIMIN NË OBLIGACIONE

#### **Cili është dallimi midis obligacionit dhe aksionit?**

Praktikisht, obligacioni është hua që i jepet emetuesit të obligacionit për një periudhë të përcaktuar. Norma e interesit të obligacionit përcaktohet në momentin e emetimit dhe garantohehet nga emetuesi. Vlera nominale e emetuar i shlyhet investitorit në datën e përcaktuar, e cila konsiderohet si përfundim i obligacionit (“data e maturimit”).

Aksioni përfaqëson një pjesë të pronësisë në shoqërinë tregtare që e ka emetuar aksionin. Shoqëria që e ka emetuar aksionin mund të paguajë dividendë, por vlera e dividendëve nuk është e përcaktuar dhe nuk garantohehet, prandaj mund të ketë luhatje në vlerë, ose mund të mos paguhet fare. Nuk ka një datë të përcaktuar shlyerjeje, dhe investitori që dëshiron ta shesë aksionin me qëllim sigurimin e mjeteve monetare do të duhet të gjejë një blerës tjetër, me të cilin duhet të bjerë dakord për çmimin e shitjes.

#### **Cili është dallimi midis obligacionit dhe depozitës bankare?**

Depozita bankare është një detyrim i bankës që e pranon depozitën. Banka duhet t’ia kthejë depozitën depozituesit kurdo që ta kërkojë ky i fundit ose në një datë të paracaktuar. Në rast të dështimit të bankës për të shlyer depozitën për shkak të paaftësisë paguese, depozituesi është i mbrojtur nga Agjencia për Sigurimin e Depozitave.

Nëse emetuesi i obligacionit nuk është në gjendje ta shlyejë vlerën nominale të obligacionit në datën e maturimit si pasojë e paaftësisë paguese, mbajtësi i obligacionit bëhet kreditor bashkë me të gjithë të tjerët të cilëve emetuesi u detyrohet për shkak të paaftësisë paguese. Shlyerja e një pjese të parave do të varet nga renditja e mbajtësve të obligacioneve në listën e kreditorëve të tjerë. Obligacionet me garanci, të cilat garantohehen me një pasuri të përcaktuar, kanë më shumë gjasë të shlyhen se sa obligacionet pa garanci.

#### **Si mund të investoj në një obligacion?**

Mund të bëni kërkesë në bazë të prospektit, i cili normalisht duhet t’ju japë informacionet e nevojshme për të qenë në gjendje të merrni një vendim të mbështetur në informim. Prospekti përmban edhe një formular kërkesë, të cilin duhet ta plotësoni dhe ta paraqisni nëpërmjet një “shpërndarësi të autorizuar” që mund të jetë një këshilltar ose broker i licencuar, emrin dhe adresën e të cilit e gjeni në prospekt.

### **A bëj mirë të investoj në një obligacion?**

Praktikisht, obligacioni është një hua që investitori ia jep emetuesit të obligacionit për një periudhë të caktuar kohore me normë interesi të fiksuar. Kur emetohet, obligacioni shitet me një vlerë të caktuar (p.sh. 1,000 lekë) për një periudhë të caktuar (p.sh. 5 vjet) dhe me normë të caktuar interesi (p.sh. 7%) për gjithë afatin e maturimit të obligacionit: në fund të afatit të maturimit të obligacionit (të 5 vjetëve) emetuesi i obligacionit i kthen paratë e investuara (në këtë rast, 1,000 lekë). Obligacionet konsiderohen si një investim relativisht me më pak rrezik, sidomos kur e krahason me aksionet, sepse interesi dhe shlyerja e obligacionit garantohet nga emetuesi. Rreziku që ka investitori që blen një obligacion ka të bëjë me faktin nëse emetuesi është apo jo në gjendje të garantojë pagesën e interesit çdo vit dhe kthimin e kapitalit në datën e maturimit të obligacionit. Ndryshe nga depozita bankare, ku depozita është e sigurt në rast të falimentimit të bankës, askush nuk e garanton pagimin e interesit të obligacionit apo kthimin e shumës së investuar në përfundim të datës së maturimit të obligacionit dhe investitori e merr të plotë riskun.

Pra, nëse mund të pranoni se investimi në obligacione ka riskun e mospagimi të interesit në afat apo ka të ngjarë që paratë që do të investoni mund të mos ju kthehen, në këmbim të mundësisë së përfitimit të një norme më të mirë interesi nga sa do të merrnit në një investim tjetër, atëherë mund të mendoni të investoni në obligacione.

### **Kush i emeton obligacionet dhe përse?**

Qeveria në nivel qendror apo lokal, si dhe kompanitë të cilat dëshirojnë ose kanë nevojë të marrin hua kundrejt një norme të fiksuar interesi, emetojnë obligacione me afat të gjatë. Qeveritë marrin hua, si për të mbuluar deficitin buxhetor, ashtu edhe për investime afatgjata në infrastrukturë. Shoqëritë tregtare marrin hua për të financuar investime afatgjata në biznesin e tyre apo për të siguruar kapital qarkullues.

Obligacionet emetohen nga qeveria, ndërmarrjet shtetërore, autoritetet vendore dhe nga shoqëritë tregtare.

### **Cili është dallimi midis obligacionit shtetëror dhe obligacioneve të tjera?**

Obligacioni shtetëror emetohet dhe garantohet nga qeveria. Obligacioni shtetëror konsiderohet investim me më pak risk në krahasim me obligacionet e tjera, duke qenë se qeveria e ka gjithmonë mundësinë e mbledhjes së tatim-taksave për të kthyer obligacionin, nëse del nevoja. Obligacionet e emetuara nga subjektet e tjera, përfshirë njësitë e qeverisjes vendore dhe ndërmarrjet shtetërore, zakonisht nuk mbulojnë me dorëzani shtetërore. Obligacionet e emetuara nga shoqëri private varen vetëm nga gjendja financiare e emetuesit.

### **A mund të blej obligacione të huaja apo obligacione në monedhë të huaj?**

Disa emetues vendas emetojnë obligacione në monedhë të huaj. Ose, në varësi të masave kontrolluese mbi këmbimin valutor, investitori mund të investojë në secilin prej obligacioneve të emetuara nga qeveritë dhe shoqëritë e huaja. Investimi në një monedhë tjetër shton edhe riskun e kursit të këmbimit krahas risqeve të tjera që duhet të marrë në analizë investitori. Nëse vlera e monedhës në të cilën shprehet obligacioni bie kundrejt monedhës vendase të investitorit, atëherë investitori do të pësojë humbje, megjithëse mund të ndodhë edhe e kundërta.

### **A i mbron kush interesat e investitorit në obligacione?**

Një dokument (i quajtur “prospekt”) ku jepen informacionet e nevojshme për të gjitha çështjet e obligacioneve, me përjashtim të obligacioneve shtetërore, duhet regjistruar pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, i cili verifikon nëse ky dokument përmban informacionet e nevojshme për t’u dhënë mundësi investitorëve të mundshëm të marrin një vendim të mbështetur në informim. Autoriteti Shqiptar i Mbikëqyrjes Financiare nuk i kontrollon informacionet dhe nuk bën rekomandime. Përmbajtja e prospektit është përgjegjësi e e plotë e emetuesit.

Ekziston kërkesa ligjore që të caktohet një agjent i mbajtësve të obligacioneve, detyra e të cilit është të përfaqësojë interesat e mbajtësve [individualë] të obligacioneve përpara emetuesit dhe, nëse është e nevojshme, në procese ligjore.

### **Nga ta di se emetuesi do ta paguajë interesin dhe do ta shlyejë obligacionin në afat?**

Shumë vende kanë agjenci të specializuara të quajtura agjenci të vlerësimit kreditor të cilat i rendisin emetuesit e obligacioneve sipas besueshmërisë ose sipas aftësisë huamarrëse të emetuesit. Në Shqipëri nuk ka ende agjenci të tilla, megjithëse ka të ngjarë që obligacionet shqiptare mund të vlerësohen edhe nga ndonjë agjenci e huaj e vlerësimit kreditor. Në mënyrë alternative, investitori duhet ta bëjë vetë vlerësimin. Prospekti përmban informacion financiar për emetuesin që i ndihmon investitorët të vlerësojnë gjendjen financiare të emetuesit. Në rastin e obligacionit të shoqërisë aksionare, është agjenti i mbajtësve të obligacioneve ai që bën njëfarë analize dhe jep informacione të mëtejshme gjatë jetës së obligacionit duke ua vënë në dispozicion mbajtësve [individualë] të obligacioneve.

### **Cili është dallimi midis obligacionit të emeluar me ofertë private dhe obligacionit të emeluar me ofertë publike?**

Sipas Ligjit nr.9879 “Për titujt”, obligacioni i emeluar me ofertë publike mund t’u ofrohet një numri dhe kategorie të pakufizuar personash të ndryshëm dhe duhet të regjistrohet për tregtim në bursë. Kjo u jep mundësi investitorëve t’i blejnë dhe shesin këto obligacione në këtë treg, nëse dëshirojnë.

Në bazë të të njëjtit ligj, obligacioni i emeluar me ofertë private mund t’u ofrohet vetëm investitorëve institucionalë (fondet e pensionit vullnetar, fondet e investimeve ose shoqëritë e sigurimit); aksionarëve ose punonjësve të emetuesit; dhe jo më shumë se 100 investitorëve të

jashtëm të identifikuar në vendimin e emetimit të obligacionit dhe oferta duhet t'i bëhet konkretisht një personi të caktuar. Obligacionet me ofertë private nuk regjistrohen ose tregtohen në bursë.

### **Çfarë bën agjenti i mbajtësve të obligacioneve?**

Agjenti i mbajtësve të obligacioneve përfaqëson grupin e mbajtësve [individualë] të obligacioneve përpara emetuesit dhe palëve të treta. Në rastin e obligacioneve të emetuara me ofertë publike, agjenti i mbajtësve të obligacioneve duhet të jetë bankë e licencuar nga Banka e Shqipërisë ose broker në tituj i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Agjenti i mbajtësve të obligacioneve caktohet nga emetuesi në rastin e obligacionit të emetuar me ofertë private ose nga mbajtësit e obligacioneve në rastin e obligacionit të emetuar me ofertë publike. Ai duhet të veprojë gjithmonë në mbrojtje të interesave të mbajtësve të obligacioneve dhe ka tagrin të bëjë padi për llogari të mbajtësve të obligacioneve në disa rrethana të caktuara.

### **Si ta dëshmoj se jam pronar i obligacionit, pasi të kem investuar?**

Historikisht, mbajtësi i obligacionit merrte një certifikatë të shtypur në letër, e cila përbënte dëshmi pronësie. Sot pronësia regjistrohet në mënyrë elektronike në një regjistër [dhe pronarit i jepet një ekstrakt i këtij regjistri]. Ky regjistër mbahet nga një ofrues i licencuar llogarish i cili është përgjegjës për ruajtjen e paprekshmërisë së regjistrimit të pronarëve dhe për regjistrimin e çdo ndryshimi të pronësisë.

### **Sa interes do të marr dhe kur do ta marr?**

Ndryshe nga interesi mbi depozitat bankare, të cilat luhaten në varësi të normave të interesit në përgjithësi norma e interesit mbi obligacionin është fiks dhe caktohet në momentin e emetimit dhe tregohet në prospekt. Ai paguhet rregullisht sipas normës së shprehur deri në shlyerje të obligacionit. Zakonisht paguhet një ose dy herë në vit.

### **Nëse blej një obligacion kur emetohet, kur do të më kthehen paratë?**

Praktikisht, obligacioni është hua që i jepet emetuesit për një periudhë të përcaktuar. Emetuesi merr përsipër ta shlyejë huanë në një datë të caktuar në të ardhmen që është fundi i jetës së obligacionit. Kjo datë mund të jetë afër, një apo dy vjet, ose edhe më larg në kohë, pesë apo dhjetë vjet. Këtë informacion e jep prospekti.

### **A mund të më kthehen paratë përpara përfundimit të jetës së obligacionit?**

Kjo do të jetë e mundshme vetëm nëse mund të gjendet një blerës tjetër për obligacionin. Mund të jetë e mundshme t'i shitet obligacioni dikujt tjetër, nëse arrini të gjeni një blerës. Nëse obligacioni që keni është emetuar me ofertë private, ai nuk mund të tregtohet në një treg publik, siç është bursa. Nëse obligacioni që keni është obligacion shtetëror, mund të arrini ta shisni

përmes tregut me pakicë të letrave me vlerë të qeverisë. Çmimi që do të merrni për obligacionin, nëse e shisni, mund të mos jetë i njëjtë me çmimin që keni paguar në momentin kur e bletë.

Çmimet e obligacioneve mund të rriten nëse kanë rënë normat e interesit pas blerjes së obligacionit dhe mund të bien nëse janë rritur normat e interesit pas blerjes së obligacionit. Çmimet e obligacioneve rriten ose bien sipas lëvizjes së normave të interesit. Me rënie e normave të interesit, çmimet e obligacioneve ekzistuese që paguajnë norma më të larta interesi rriten; ose me rritjen e normave të interesit, çmimet e obligacioneve ekzistuese që paguajnë norma më të ulëta interesi bien.

### **A mund t'i ndryshojë emetuesi kushtet e obligacionit që ka emetuar?**

Emetuesi nuk mund ta bëjë këtë sipas qejfit. Ndryshimi mund të bëhet vetëm me pëlqimin e mbajtësve të obligacioneve të marrë në asamblenë e tyre përmes votimit. I takon emetuesit t'i bindë mbajtësit e obligacioneve se ndryshimi i propozuar nuk bie ndesh me interesin e tyre.

### **Çfarë u ndodh çmimeve të obligacioneve në rast inflacioni?**

Duke qenë se obligacioni paguan interes me normë fikse dhe një vlerë fikse në fund të jetës së tij, obligacionit i bie vlera sipas normës së inflacionit. Nëse inflacioni është shumë i lartë, vlera e obligacionit në raport me fuqinë aktuale blerëse bie, njësoj siç i bie edhe parasë.

### **Çfarë ndodh nëse emetuesi nuk e paguan interesin apo kapitalin në shlyerje?**

Kjo quhet moskthim i detyrimit. Mbajtësi i obligacionit apo agjenti i tij ka të drejtë të bëjë padi kundër emetuesit që nuk i bën këto pagesa brenda afatit.

### **Po sikur emetuesi të mos ketë gjendje paguese dhe të hyjë në likuidim?**

Mbajtësi i obligacionit kthehet në kreditor. Nëse mbajtësi i obligacionit do të marrë apo jo ndonjë pagesë, kjo varet nga fakti nëse obligacioni është me garanci apo pa garanci, varet nga të drejtat e kërkueshme të kreditorëve të tjerë të cilët mund të renditen më lart në raport me mbajtësin e obligacionit dhe nga suksesi i likuiduesit sa i takon krijimit të fondeve përmes shitjes së aktiveve për të shlyer kreditorët.



## ANEKSI 7

### DEKLARATË – TIP

Unë i/e nënshkruari/a (emër mbiemër), shtetas/e....., lindur më datë ...../...../....., në ..... , banues/e në ..... , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me dokumentin indentifikues nr....., me vullnetin tim të lirë e të plotë, në dijeni të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se:

E njoh obligacionin (jepet lloji i obligacionit) dhe marr përsipër të gjitha rreziqet që mund të shkaktohen nga investimi dhe jam i informuar se obligacioni (lloji i obligacionit), nga pikëpamja e radhës së pretendimeve të shlyerjes është pas (jepet radha e shlyerjes së obligacionit)

Data e nënshkrimit

DEKLARUESI

---

(Emër, Mbiemër)